

Mars 2021



E DREJTA E INFORMIMIT

2020

Informimi në kohë krize dhe problemet e tjera të zakonshme



National Endowment for Democracy
Supporting freedom around the world

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e National Endowment for Democracy.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës Res Publica dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e National Endowment for Democracy.

Autorë:

Av. Dorian Matlija

Dr. Irena Dule

Botues: Qendra “Res Publica”

Redaktor: Dorian Matlija

Tirazhi: 200 kopje

Layout & Print: Expo Vision Albania

E DREITA E INFORMIMIT

2020

PERMBAJTJA

5 Hyrje

7 Metodologjia

9 Emergjencia e Covid-19. Standardet e Këshillit të Evropës për të drejtën e informimit në kohë krize dhe zbatimi i tyre në Shqipëri

9 Standardet e Këshillit të Evropës për të drejtën e informimit gjatë emergjencave

11 Zbatimi i standardeve të Këshillit të Evropës gjatë pandemisë së Covid-19 në Shqipëri gjatë 2020

17 Veprimtaria e Komisionerit për të Drejtën e Informimit

17 Vlerësimi punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit

22 Vlerësim i treguesve cilësorë i transparencës dhe ndikimit të Komisionerit

29 Transparenca e institucioneve

29 Reagimi i institucioneve ndaj kërkesave për informacion

32 Vlerësim i transparencës proaktive sipas treguesve të zakonshëm

35 Litigime strategjike gjatë 2020 dhe aspekte të veçantë që prekin të drejtën e informimit

35 Kompensimi i dëmit jopasuror të shkatuar nga refuzimi i informacionit, risi për jurisprudencën shqiptare

36 Konsolidimi i praktikës së gjykatës për dhënien e vendimeve me ekzekutim të përkohshëm në 6 raste

37 Sekret i shtetëror, një justifikim për të mos bërë publik një Vendim të Këshillit të Ministrave

38	Aksesi i gazetarëve në proceset gjyqësorë dhe roli i gjyqtarit të medias
39	Zyra e Presidentit të Republikës, rezistencë aktive ndaj ekzekutimit të vendimeve gjyqësore

41 Të dhëna nga platforma “Publeaks.al”

42	Përdorimi i faqes Publeaks.al
42	Aplikantët sipas grupmoshave
43	Aplikantët sipas arsimimit
44	Aplikantët sipas gjinisë
45	Aplikacioni Publeaks.al në platformën Android

47 Konkluzione

48	Për sa i përket standardeve të Këshillit të Evropës për të drejtën e informimit në kohë krize
49	Për sa i përket veprimtarisë së Komisionerit për të drejtën e informimit
50	Për sa i përket reagimit ndaj kërkesave për informacion
51	Për sa i përket problematikave të veçanta
53	Për sa i përket programeve të transparencës
54	Për sa i përket interesit të qytetarëve për të përdorur të drejtën e informimit

55 Rekomandime

1. HYRJE

Ky raport vjetor është edicioni i 7-të, që vjen në vijim të një pune disa vjecare që Qendra Res Publica i ka dedikuar të drejtës së informimit, nisur që përpara miratimit të ligjit “Për të drejtën e informimit” në vitin 2014 e deri më sot.

Për çdo vit janë bërë monitorime të vazhdueshme, testime të praktikës administrative apo gjyqësore për të vlerësuar, vendosur dhe rishikuar kufijtë e zbatimit të ligjit, të praktikës së organeve publike dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit, duke krijuar një bazë të mirë të dhënash sa i takon efektivitetit të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit në Shqipëri.

Raporti u përgatit me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED), në kuadër të projektit “Promovimi i lirisë së shprehjes dhe të drejtës së informimit në Shqipëri”.

Viti 2020 ishte një vit shumë i pazankontë për shkak të reagimit ndaj pandemisë së Covid-19. Për këtë arsye, ndryshe nga vitet e mëparshme, në këtë raport prezantohet zbatimi i parimeve dhe rregullave të posaçme për të drejtën e informimit dhe performancën e qeverisë, lidhur me publikimin e njoftimeve të besueshme, transparencën proaktive, sjelljen e institucioneve ndaj kërkesave për informacion, në situatatën e fatkeqësisë natyrore. Këto rezultate vijnë si gjetje nga monitorimi për vitin 2020.

Gjatë krizave aksesit në informacion është më i rëndësishëm se kurrë. Vetëm përmes informimit të saktë dhe të shpejtë publiku ka mundësi të dijë saktësisht se si po e trajton krizën qeveria. Kjo e fundit është përgjegjëse për politikat e saj gjatë krizave dhe një komunikim i saj i cunguar me publikun mund të t'i hapë rrugë abuzimit dhe korrupsionit. Një informim i plotë krijon premisa të fitimit të besimit të publikut te Qeveria dhe te aftësia e saj për të menaxhuar krizën, duke krijuar siguri te publiku.

Në këtë kontekst, raporti këtë vit fokusohet më së shumti tek standardet e posaçme të Këshillit të Evropës për lirinë e shprehjes dhe informimit në raste krizash dhe si janë reflektuar këto standarde nga qeveria shqiptare gjatë krizës së shkaktuar nga Covid-19, gjatë vitit 2020.

Raporti prezanton edhe rezultatet që dalin nga përpunimi i të dhënave të marra nga platforma Publeaks.al, e cila u krijua nga Res Publica në fund të vitit 2016, për t'i ardhur në ndihmë gazetarëve, studiuesve, qytetarëve aktivë, që dëshirojnë të informohen për çështje të ndryshme të veprimtarisë shtetërore, duke lehtësuar aksesin e tyre në informacionin publik. Një qytetar mjafton të shfaqë interes për një çështje të caktuar, pa pasur nevojë të ketë dijeni se kujt duhet t'i drejtohet pyetja apo si duhet formuluar kërkesa. Staf i që menaxhon platformën përgatit pyetjen në formën e duhur, duke i kushtuar rëndësi formulimit sa më konkret të kërkesës për të mos pasur vend për paqartësi nga ana e institucioneve publike që u drejtohet kërkesa. Më pas stafi ndjek të gjitha procedurat, duke përfshirë ankimet administrative dhe gjyqësore, deri në marrjen e plotë të informacionit. Pasurimi i platformës e shndërron atë në një arkivë me një shumëllojshmëri informacionesh, të cilat janë siguruar më parë nga aplikimet në platformë dhe janë të aksesueshme nga publiku në çdo kohë.

Res Publica, si një nga organizatat më aktive në fushën e monitorimit dhe testimit të respektimit të së drejtës së informimit, edhe gjatë këtij viti është përpjekur ta verë në provë efektivitetin e ligjit, duke testuar në mënyrë aktive, me fokus të veçantë aty ku perceptohet se ka më shumë dobësi, të cilat përbëjnë shteg për zyrtarët që nuk kanë vullnet të japin informacionin e kërkuar. Gjatë këtij viti ka qenë testimi i disa çështjeve kundër institucioneve qendrore në vend, me objekt të njëjtë, me qëllim vlerësimin e vendimarrjes së gjyqtarëve të ndryshëm, në të njëjtën çështje, me synimin afatgjatë për të kërkuar në vazhdim unifikimin e praktikës gjyqësore nga Gjykata e Lartë.

Duke marrë shkas nga gjetjet e prezantuara në të, raporti shoqërohet me rekomandimet përkatëse për të përmirësuar komunikimin publik të qeverisë, me qëllim rritjen e transparencës dhe rritjen e besimit të publikut te qeveria gjatë krizave, në përfitim të të gjithëve.

Autorë:

Av Dorian Matlija
Dr. Irena Dule

2. METODOLOGJIA

Situatat e jashtëzakonshme nuk vlerësohen me mjetet dhe metodologjitë e zakonshme, të cilat marrin në konsideratë vlerësimin e elementëve rutinë të zbatimit të ligjit. Në kohë krizash, merr rëndësi parësore mënyra e komunikimit të qeverisë me publikun, hapja e saj ndaj gazetarëve dhe bashkëpunimi me këta të fundit për të menaxhuar së bashku krizën dhe efektet e saj anësore që shkaktohen nga lajmet e rreme që krijojnë panik.

Në këtë kontekst ky raport në pjesën e parë të tij trajton se cili është standardi dhe interpretimi i Këshillit të Evropës në trajtimin e së drejtës së informimit në situatat e gjendjes së jashtëzakonshme. Gjithashtu është vlerësuar se si ka qenë sjellja e institucioneve në përmbushje të këtyre nevojave dhe standardeve ndërkombëtare.

Në pjesën e dytë trajtohen të dhënat e mbledhura nga monitorimi i veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit. Ky i fundit ka një rol kyç dhe detyrime ligjore të posaçme, rol i cili nëse luhet me përgjegjësinë e duhur sjell pasoja të dukshme në përmirësimin e transparencës së institucioneve dhe respektimin e të drejtës së informimit.

Në pjesën e tretë, ky raport, në vazhdimësinë e raporteve të përvitshme që nga viti 2015, ka për qëllim prezantimin e të dhënave të mbledhura nga monitorimi i zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, gjatë vitit 2020. Gjetjet janë krahasuar me ato të pesë viteve të shkuara, duke ruajtur të njëjtën metodologji për sa ka qenë e mundur. Kjo pjesë bazohet në të dhënat e mbledhura si më poshtë:

- është testuar dhe vlerësuar reagimi i institucioneve, duke vlerësuar përmes kriterëve të matshme sjelljen e tyre ndaj kërkesave për informacion. Më konkretisht janë dërguar 227 kërkesa për informacion dhe është monitoruar i gjithë procesi administrativ i tyre. Kërkesat kanë nisur kryesisht përmes aplikimit në faqen Publeaks.al. Nga 227 kërkesat janë përzgjedhur 205 prej tyre, për të bërë një krahasim të drejtë me periudhat e mëparshme dhe për të bërë të mundur ruajtjen e të njëjtës balancë në ndarjen e fushave si në vitet e mëparshme. Disa nga treguesit kryesorë të matshëm që janë marrë në konsideratë janë: (1) Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes; (2) Plotësia dhe saktësia e përgjigjes; (3) Reagimi i institucioneve pas ankimit administrativ.

- si për cdo vit, në fokus ka qenë transparenca proaktive e institucioneve publike, duke vlerësuar *programet e transparencës* në të cilat publikohen informacionet pa nevojën e një kërkesë nga ana e publikut. Kështu janë vlerësuar plotësimi, përshtatja dhe përditësimi i programeve të transparencës. Më konkretisht janë përzgjedhur për monitorim 100 autoritete publike me rëndësi më të madhe, duke marrë kampione me nga 20 institucione, në 5 kategoritë kryesore: (1) institucione kushtetuese dhe të pavarura; (2) institucione qendrore të pushtetit ekzekutiv; (3) institucione të vartësisë të pushtetit ekzekutiv; (4) institucione të pushtetit vendor; (5) institucione të pushtetit gjyqësor. Monitorimi është fokusuar në përmbushjen e të gjithë elementëve që duhet të përmbajë një program transparence, duke i dhënë rëndësi atyre elementëve që lidhen me informacione të vlefshme dhe përgjithësisht sensitive dhe duke i dhënë një rëndësi më të vogël informacioneve të tjera. Gjithashtu është monitoruar caktimi i koordinatorëve për të drejtën e informimit, si dhe publikimi dhe mirëmbajtja e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.

Në pjesën e katërt është trajtuar praktika gjyqësore. Res Publica ka vijuar edhe këtë vit me ndjekjen në rrugë gjyqësore të rasteve të refuzimit të dhënies së informacionit publik. Kjo nga njëra anë për t'i shërbyer me besnikëri aplikuesve të platformës Publeaks, të cilët në një pjesë të madhe janë gazetarë dhe aktivistë të shoqërisë civile, kërkesat e të cilëve nuk kanë marrë përgjigje nga institucioni dhe nga ana tjetër me dëshirën për të përmirësuar praktikën gjyqësore, të vendosur më parë nga kjo zyrë.

Në pjesë e pestë prezantohen të dhënat e mbledhura nga aplikimet në Publeaks.al. Edhe pse nuk përbën qëllim parësor të këtij raporti, janë parë me interes edhe aspekte që kanë të bëjnë me motivimin e qytetarëve për t'u informuar, të tilla si mosha e aplikantëve, arsimi, gjinia, kategoria, objekti i kërkesave, etj.

3. EMERGJENCA E COVID-19. STANDARDET E KËSHILLIT TË EVROPËS PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT NË KOHË KRIZE DHE ZBATIMI I TYRE NË SHQIPËRI

3.1. Standardet e Këshillit të Evropës për të drejtën e informimit gjatë emergjencave

Respektimi i të drejtës së informimit në Shqipëri në situata të zakonshme është paraqitur cdo vit si një sfidë. Edhe më e vështirë bëhet kjo sfidë në rastet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, gjendje e cila shoqërohet me një sërë kufizimesh, përfshirë të drejtën e informimit si pjesë e të drejtave themelore të njeriut. E drejta e informimit është një e drejtë që njihet dhe i është dhënë rëndësi nga Këshilli i Evropës, si në kohë “pazeje”, ashtu edhe në kohë “lufte”.

Sipas Këshillit të Evropës, bashkësia lider për standardet e të drejtave të njeriut, ofrimi i informacionit të menjëhershëm dhe të saktë për rreziqet ndaj shëndetit publik dhe masat e marra nga qeveritë për t’iu kundërvënë këtyre rreziqeve, është pjesë esenciale e trajtimit të pandemisë Covid-19¹. Gjendja e fatkeqësisë natyrore si një gjendje jo e zakonshme është rasti më i mirë kur gjen shprehje bashkëudhëtimi i të drejtës së informimit me lirinë e shprehjes, të mbrojtura jo rastësisht nga i njëjti nen në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Për këtë arsye pjesa në vijim ka në fokus të drejtën e informimit duke e vlerësuar ngushtësisht të lidhur me lirinë e shprehjes.

Standardet bazë për të drejtën e informimit janë vendosur në nenin 10 të KEDNJ, i cili sanksionon të drejtën për të dhënë dhe marrë informata. Edhe pse Neni 10 nuk përmban një referencë të veçantë për lirinë e shtypit dhe rolin e gazetarëve, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) jo vetëm që ka përcaktuar që në fillim që termi “çdokush” përfshin gazetarët, por gjithashtu ka ofruar një hapësirë më të gjerë mbrojtjeje për gazetarët për shkak të rolit të rëndësishëm që ata luajnë në një shoqëri demokratike, përkatësisht atë të “rojtarit publik”. Si rezultat, GJEDNJ ka pranuar në mënyrë të përsëritur që gazetarët duhet të gëzojnë një fushëveprim më të gjerë në ushtrimin e së drejtës së tyre për lirinë e shprehjes dhe informimit sesa individët e tjerë dhe merr parasysh nëse personi në fjalë ka vepruar në cilësinë e tij / saj si gazetar apo jo.²

1 Shih: <http://www.coe.int/en/ëeb/freedom-expression/freedom-of-expression-and-information-in-times-of-crisis>

2 Jawoski kundër Polonisë [GC] (1999), paragrafi 32: “Vërejtjet e aplikantit nuk ishin pjesë e një

Gjithashtu, sipas GJEDNJ, shtetet anëtare kanë detyrimin që të garantojnë diversitetin e medias, për t'u siguruar që publiku të ketë akses në përmbajtje të cilat pasqyrojnë sa më shumë që të jetë e mundur larminë e opinioneve të hasura në shoqërinë së cilës i drejtohen programet.³ Liria e shprehjes duhet të jetë e rrënjësuar në parimin e pluralizmit për të siguruar që publiku të ketë akses në një sërë informacionesh e idesh. Një situatë në të cilën njëri grup dominon përmbajtjen e shtypit ose të medias audiovizuale në vend [...] nuk mund të justifikohet sipas Nenit 10 nëse nuk mund të tregohet se ka pasur një nevojë urgjente për të.⁴

Konventa për Aksesin në Dokumentet Zyrtare (Konventa e Tromsø), është një tjetër akt, i cili forcon të drejtën e informimit, e miratuar nga Këshilli i Evropës. Kjo konventë hyri në fuqi më 01.12.2020, pas ratifikimit edhe prej shtetit të dhjetë (Ukrainës). Ky dokument nuk është ratifikuar ende nga Shqipëria, por mund të themi se në vija të përgjithshme legjislacioni ynë parashikon rregulla të ngjashme me ato të kësaj konvente.

Informimi në raste krizash nuk është në objektin kryesor të rregullimeve të mësipërme, pasi ky problem është plotësisht i zgjidhshëm nëse interpretohen dhe zbatohen drejt rregullat e zakonshme. Për këtë arsye, për rrethana të veçanta, Këshilli i Evropës ka parashikuar edhe një instrument të *soft law* që trajton pikërisht aspekte të lirisë së shprehjes dhe informimit në raste krizash. Në mbledhjen e 1005-të të Komitetit të Ministrave u miratua Udhëzimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe informimit në kohë krizash⁵.

Ky dokument, ndër të tjera thekson:

1. Shtetet anëtare duhet të garantojnë lirinë e lëvizjes dhe aksesin në informacion të profesionistëve të medias në kohë krize. Nevoja për të garantuar sigurinë e gazetarëve, nuk duhet të përdoret nga shtetet si një pretekst për të kufizuar në mënyrë të panevojshme të drejtat e profesionistëve të medias;
2. Në mënyrë të veçantë, profesionistët e medias duhet të kenë akses në zonat e krizës. Nëse është e nevojshme, shtetet mund të zhvillojnë një sistem akreditimi, por ky duhet të përdoret në përputhje me Rekomandimin nr. R(96)4 të Komitetit të Ministrave “për mbrojtjen e gazetarëve në situatë konflikti”;
3. Autoritetet që menaxhojnë krizën duhet të sigurojnë informacion të rregullt për të gjithë profesionistët e medias që mbulojnë ngjarjet, përmes deklaratave, konferencave për shtyp dhe mjeteve të tjera të përshtatshme;
4. Shtetet nuk duhet të intimidojnë profesionistët e medias përmes padive apo sanksioneve joproporcionale;
5. Autoritetet gjithmonë duhet t'i sigurojnë publikut akses të lirë në informacion, përfshirë edhe përmes medias;
6. Gjykatat duhet të peshojnë gjithmonë nevojën e publikut për t'u informuar, mbi nevojën për të mbrojtur integritetin e procedimeve;

diskutimi të hapur për çështje me interes publik; as nuk kishin të bënin me çështjen e lirisë së shtypit pasi aplikanti, megjithëse gazetar me profesion, në mënyrë të qartë ka vepruar si një individ privat në këtë rast.”

3 Informationsverein Lentia dhe të Tjerët kundër Austrisë (1993).

4 Di Stefano kundër Italisë [GC] (2012).

5 Shih: CM/Del/Dec(2007)1005/5.3-appendix11, i cili mund të aksesohet në: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016805ae60e

7. Shtetet duhet të konsiderojnë përgjegjësinë administrative apo edhe penale për zyrtarët që përpiqen të manipulojnë opinionin, përfshirë edhe përmes medias, sidomos duke shfrytëzuar dobësitë e publikut në raste krizash;
8. Vetë-rregullimi është mekanizmi më i përshtatshëm për etikën në media dhe shtetet inkurajojnë bashkëpunimin mes organeve vetë-rregulluese;
9. Në raste krizash, autoritetet rregullatore, organizatat joqeveritare dhe media, përfshirë pronarët, botuesit dhe redaktorët, të ngrenë një forum vullnetar, që përmes dialogut të ushtrojnë lirinë e shprehjes dhe atë të informimit në raste krizash;
10. Donatorët qeveritare (por jo vetëm) inkurajohen që të përfshijnë zhvillimin dhe mbështetjen e medias si pjesë e strategjisë së zgjidhjes së krizës.

Janë elementët e kësaj liste nga ku jemi nisur për të vlerësuar repsektimin e të drejtës së informimit gjatë vitit 2020. Kjo për arsye se metodat e zakonshme të vlerësimit të garantimit të së drejtës së informimit janë të krijuara për të bërë vlerësim në situatë normale dhe nuk mund të përdoren të veçuara për të vlerësuar zbatimin e të drejtës së informimit në raste krizash.

3.2. Zbatimi i standardeve të Këshillit të Evropës gjatë pandemisë së Covid-19 në Shqipëri gjatë 2020

Republika e Shqipërisë është shtet anëtar i Këshillit të Evropës që vitin 1995 dhe ka detyrimin të zbatojë në mënyrë të drejtpërdrejt Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në nenin 10 sanksionon lirinë e shprehjes dhe të drejtën e informuar, duke u shprehur që çdokush ka të drejtën të kërkojë, japë e marrë informacione e ide. Kufizimet duhet të jenë të vendosura me ligj, që ndjekin një qëllim legjitim dhe të jenë proporcionale e të nevojshme në një shoqëri demokratike. Kuptimi i këtyre koncepteve zbërthehet nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nga shumë instrumente të tjerë siç janë edhe ato që quhen *soft law*, që nuk janë forcërisht të zbatueshme por vendosin standarde të cilat janë matës të nivelit të një shoqërie demokratike.

Pikërisht, për të matur sjelljen e autoriteteve publike shqiptare gjatë pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 gjatë vitit 2020, kemi marrë në analizë aspektet e përmendura në listën e mësipërme të thjeshtuar në dhjetë pika kryesore.

3.2.1. Detyrimet e autoriteteve publike për të informuar publikun gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore

Përveç sa kërkohet nga standardet e Këshillit të Evropës të përmendura më sipër, legjislacioni shqiptar ka parashikuar detyrime të veçanta të organeve shtetërore, lidhur me të drejtën e informimit dhe bashkëpunimin me aktorë joqeveritarë. Sipas ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” organet shtetërore janë të detyruara të bashkëpunojnë me organizatat e shoqërisë civile.⁶ Sipas këtij ligji dhe relacionit shoqërues të tij⁷, duket qartë se ligjvënësi e ka konsideruar të rëndësishëm bashkëpunimin me organizatat, të cilave u ka dhënë të drejtën të informohen në mënyrë të përhershme dhe të përditësuar për risqet nga fatkeqësitë, si dhe

6 Kreu IX i ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”

7 Shih: <https://parlament.al/Files/ProjektLigje/20190610101549RELACION%20-%20MBROJTA%20CIVILE.pdf>

për masat e nevojshme dhe ato të marra për menaxhimin e tyre. Shoqatat dhe organizatat e shoqërisë civile kanë të drejtë të kryejnë studime për çështje të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë natyrore, të paraqesin konkluzionet përkatëse dhe të jenë partnerë në zbatimin e politikave të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë.⁸

Shembujt në vijim tregojnë për një situatë ku ka munguar bashkëpunimi mes qeverisë dhe faktorëve të tjerë dhe se qeveria ka monopolizuar të gjithë veprimtarinë për zgjidhjen e krizës, përfshirë edhe komunikimin me publikun, duke mos zbatuar parimet e ligjit të sipërpërmendur.

Pas tërmetit të 26 Nëntorit 2019 u shfaqën shenja të një nisjeje të bashkëpunimit mes autoriteteve dhe subjekteve të tjerë, siç ishte rasti i Komitetit të Rindërtimit, duke i mbajtur publike mbledhjet e para, por bashkëpunimi i mëtejshëm me publikun ka mungoi, sidomos gjatë vitit 2020, kur u shtua edhe fatkeqësia natyrore e Covid-19. Mediat dhe organizatat nuk kanë pasur bashkëpunim me autoritetet, përveç rasteve të dhënies së ndihmave.

Në lidhje me mbështetjen e medias dhe organizatave për çështje të raportimit, nuk vihet re ndonjë mbështetje nga shteti. Organizmi kryesor për mbështetjen e shoqërisë civile është Agjencia për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile, e cila gjatë pandemisë ka pasur thirrje për mbështetje për shkak të Covid-19, por në asnjë prej projekteve fituese nuk rezulton të jetë kërkuar ndihmë për çështje të lirisë së informimit, medias, etj.⁹

Viti 2020, duke nisur që nga data 9 Mars, kur u deklarua zyrtarisht se Shqipëria ishte prekur nga Covid-19, u shoqërua me kufizime edhe më të mëdha të informacionit. Qeveria reagoi menjëherë duke urdhëruar një bllokim të gjatë prej dy muajsh me masa të ashpra kufizuese, gjë që cenoi indirekt edhe veprimtarinë e gazetarëve për të përcjellë informacione të sakta te publiku. Gjendja e jashtëzakonshme u shpall më 25 Mars 2020 dhe qendroi në fuqi deri më 23 Qershor 2020. Në këtë kohë, më 31 Mars 2020, shteti shqiptar derogoi në mënyrë të përkoshme disa nene të KEDNJ (nenet 8 dhe 11 të Konventës, si dhe nenet 1 dhe 2 të Protokollit shtesë dhe neni 2 i Protokollit 4), deri më 25 qershor 2020.¹⁰

Derogimi, pavarësisht se është një mjet që parashikohet nga vetë Konventa, është rruga më e shkurtër dhe duhet të jetë alternativa e fundit, e jo të zgjidhet kur nuk dëshirohet të aplikohet parimi i balancës së të drejtave dhe detyrimeve. Në rast se shteti do të kishte vullnetin të aplikonte këtë parim, nuk do të kishte asnjë arsye pse të tërhiqej nga Konventa. GJEDNJ në çdo rast gjatë gjykimit të kufizimit të të drejtave të njeriut vlerëson pikërisht balancën e proporcionalitetit, e thënë ndryshe vlerëson nëse kufizimi i një të drejte është i domosdoshëm në rrethana të caktuara, në një shoqëri demokratike.

Për Këshillin e Evropës, siç buron edhe nga udhëzimet e këtij organi, informimi publik, me saktësi dhe në kohën e duhur, sidomos për çështje të veçanta, të lidhura me gjendjen e fatkeqësisë natyrore, ka një rol kyç dhe një kontribut pozitiv në parandalimin dhe zbutjen e gjendjes. Nëse informacioni vjen në mënyrë të centralizuar, kjo ka pasoja si në shtimin e pasigurisë te publiku, ashtu edhe në nxitjen e propagandës.

Pikërisht kjo e fundit ndodhi në Shqipëri. Gjatë kësaj kohe, qeveria pati një qasje tepër të ashpër retorike mbi virusin, duke përmendur vazhdimisht situatën që ishte “e ngjashme

8 Kreu IX i ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”

9 Shih: <http://www.amshc.gov.al/web/thirrje/13/Lista%20e%20projekteve%20fituese%20-%20Th13.pdf>

10 Shqipëria ka ratifikuar Konventën Europiane për të Drejtat të Njeriut (KEDNJ) në korrik 1996, së bashku me protokollet shtesë të saj, 1, 2, 7 dhe 11.

me luftën”, virusin e quajti “armiku i padukshëm”, nxori në rrugët qendrore të kryeqytetit automjetet e blinduara dhe sanksionoi gjyba të rënda, duke krijuar një situatë frike te popullata.

Duke nisur nga mesi i muajit Maj 2020 bllokimi u lehtësua dhe jeta nisi të kthehej ngadalë në një gjendje më normale. Në këtë kohë niveli i infeksionit ishte më pak se 20 persona në ditë, ndërsa deri në fund të vitit u rrit gradualisht deri mbi 1000 persona në ditë, pavarësisht se kjo rritje nuk shkaktoi më të njëjtin reagim nga qeveria.

Sipas OBC Transeuropa, në përgjithësi, u vu re një konfuzion midis popullatës në lidhje me masat e miratuara, si dhe mosbesimit dhe perceptimeve negative mbi aftësinë e Shqipërisë për të trajtuar siç duhet situatën, veçanërisht kur merret parasysh numri i profesionistëve mjekësorë që migruan kohët e fundit në Gjermani. Gjatë periudhës ekzistoi një frikë se shkalla e infeksionit mund të jetë ende subjekt i ndryshimit.¹¹ Sipas këtij burimi, një aspekt kryesor në menaxhimin e pandemisë qëndronte në komunikimin efektiv të rreziqeve dhe komunikimin e qëndrueshëm mes qeverisë dhe publikut. Shqipëria krijoi një Komitet Teknik të Ekspertëve të ngarkuar me marrjen e vendimeve për të përmbajtur epideminë. Sidoqoftë, puna e Komitetit u shoqërua me një informacion të kufizuar publik mbi kompetencat e tij dhe shkallën në të cilën rekomandimet e tij u shndërruan në vendime politike. Për një kohë të gjatë, deri në fillim të muajit Maj 2020, edhe emri i kryetarit të Komitetit nuk u bë i ditur.

Situata e pandemisë u shfrytëzua për propagandë nga Kryeministri Edi Rama, i cili mori drejtimin e komunikimit publik me një prani të vazhdueshme në rrjetet sociale dhe transmetuesin online personal ERTV. Vetëm në muajin e parë të bllokimit, Kryeministri publikoi 407 postime në Facebook (13 në ditë) dhe 47 orë video, duke krijuar kështu përvojën e parë të qeverisjes së Shqipërisë përmes mediave sociale.¹²

“Në thelb, Kryeministri ka monopolizuar jo vetëm përmbajtjen (çfarë mësojmë dhe mendojmë për krizën), por edhe formulimin (në çfarë mënyrash mendojmë për krizën) dhe mediat (si i marrim informacionet)”, shpjegon Blerjana Bino, bashkëthemeluese e Shkenca dhe Inovacioni për Zhvillimin (SCiDEV).¹³

Shumica e vendimeve u botuan fillimisht në llogarinë e Kryeministrit në Facebook dhe më vonë në Fletoren Zyrtare, ndërsa “konferencat për shtyp” në të vërtetë nuk ishin të hapura për gazetarët.

Një centralizim i tillë i informacionit u motivua me nevojën për të luftuar lajmet e rreme dhe “infodeminë” në lidhje me koronavirusin. Sidoqoftë, “...narrativa e qeverisë për gjendjen e luftës kërcënon të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe lirinë e medias në një mënyrë jo proporcionale përballë situatës”, argumenton Blerjana Bino.

Në Raportin e Indeksit të lirisë së Medias nga “Reporterë pa Kufi”, për vitin 2019, Shqipëria rezultonte me një liri të përkeqësuar të medias, dhe renditej dy vende më poshte sesa një vit më parë.¹⁴ Sipas raportit, shkaqet e rënies ishin ligjet kundër lirisë së medias, konkretisht paketa “Anti Shpifje” e qeverisë që synonte mbylljen e mediave kritike, u theksua në raport. Në vitin 2020, Shqipëria ra edhe me dy vende të tjerë, duke u renditur në vendin e 84-t.¹⁵

11 Shih: <https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/Albania/Albania-public-information-becomes-a-casualty-of-COVID-19-202724>

12 Shih: <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=2981601841883799&set=a.118774118166600&type=3&theater>

13 Shih: <https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/Albania/Albania-public-information-becomes-a-casualty-of-COVID-19-202724>

14 Shih: <https://rsf.org/en/ranking/2019>

15 Shih: <https://rsf.org/en/ranking/2020>

Sipas Osservatorio Balcani e Caucaso Transeuropa, Covid-19 vuri në dukje dobësi të informimit publik në Shqipëri. Monopolizimi i komunikimit për koronavirusin ngriti shqetësime për llogaridhënien e qeverisë për menaxhimin e pandemisë, si dhe për lirinë e medias.¹⁶

Shembujt e mësipërm janë dhënë për të krijuar një panoramë për mundësinë e informimit të saktë, të menjëhershëm gjatë kushteve të gjendjes së jashtëzakonshme, kur njëkohësisht ka një mori informacionesh të paverifikuara që e polarizojnë publikun në qendrimet në lidhje me ekzistencën e rreziqeve dhe efektivitetin e masave të marra nga qeveria, të propozuara ose jo nga komuniteti shkencor, i cili vetë ka shfaqur kontradikta në fakte dhe analiza. Një situatë e tillë nuk ka kontribuar në mënyrë të shëndetshme në formimin e një kulture tolerance dhe mirëkuptimi midis grupeve të ndryshme në shoqëri dhe në marrëdhëniet e besimit mes publikut dhe qeverisë.

Ndërsa në shumë vende të botës, autoritetet shëndetësore komunikojnë me publikun përmes konferencave për shtyp të hapura për gazetarët (kujto këtu rastin e Italisë që siguronte një komunikim të përditshëm në orën 18.00 mes zyrës së Mbrojtjes Civile dhe gazetarëve), ose me komunikime të drejtpërdrejta nga terreni, në Shqipëri nuk është lehtësuar kjo mënyrë komunikimi. Pas 9 Marsit nuk u zhvilluan konferenca për shtyp nga kryeministria apo Ministria e Shëndetësisë. Informacionet e përditësuara fillimisht montoheshin dhe transmetoheshin online. Edhe pse çdo ditë nga foltorja e Ministrisë së Shëndetësisë kanë dalë specialistë, profesionistë për të informuar mbi situatën e përhapjes së virusit, informacioni që jepnin në përgjigjet e pyetjeve të gazetarëve, të cilat u dërgoheshin orë më parë, ishte i kufizuar.¹⁷

Gjatë periudhës së krizës së shkaktuar nga Covid-19, nga regjistri i ankesave të paraqitura pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit, numri më i madh i përket ministrive dhe institucioneve në varësi të tyre, si dhe ndaj Bashkisë së Tiranës. Disa gazetarë konfirmojnë se gjatë kësaj kohe kanë kërkuar informacione, por nuk kanë marrë përgjigje në pjesën dërmuese të rasteve. Përveç gazetares investigative Lindita Çela, e cila ka kontaktuar direkt me qendrën Res Publica për këtë problematikë, ka edhe raste të bëra publike në media. Për shembull, qendra Faktoje (një organizatë që kryen veprimtarinë e vëfrimit të fakteve), e drejta e informimit është vështirësuar gjatë pandemisë së Covid-19.¹⁸

3.2.2. Informimi publik u cënohet për shkak të konfuzionit të akteve rregullatore për pandeminë

Në situata emergjente është e pritshme që të ketë miratim me urgjencë të akteve normative, urdhërave, udhëzimeve, të shumtë, të cilët mund të lindë nevoja të rishikohen. Por, nëse akte të tillë rregullojnë ndryshojnë shumë shpesh dhe pa plan konkret afatmesëm, kjo shkakton anomali në të kuptuarin dhe zbatimin e tyre nga publiku.

Gjatë pandemisë së Covid-19 qeveria ka miratuar një numër rekord aktesh në një kohë të shkurtër. Janë rreth 250 akte të miratuar në vetëm dy muaj¹⁹, të cilët ndryshoheshin fillimisht në llogarinë personale në rrjetin social Facebook të Kryeministrit Edi Rama dhe më pas publikoheshin në Fletoren Zyrtare.

16 Shih: <https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/Albania/Albania-public-information-becomes-a-casualty-of-COVID-19-202724>

17 Shih: <https://a2news.com/2020/05/07/media-ne-pandemi-informacioni-ne-karantine-por-cfare-ndodh-ne-bote/>

18 Shih: <https://faktoje.al/e-drejta-per-informim-veshtiresohet-gjate-pandemise-covid-19/>

19 Shih: <https://portavendore.al/dhomaeligjit/librari-ligjore/legjislacioni-per-situaten-e-krijuar-nga-covid-19/>

Në pamje të parë, duket se e drejta e informimit për aktet ligjore është garantuar, pasi, pavarësisht se në ndonjë rast me vonesë, aktet janë publikuar në Fletoren Zyrtare. Por, një nga elementët që e bën informacionin të vlefshëm nuk është vetëm aksesimi i tij, por edhe kuptueshmëria e tij. Kështu, me një mori aktesh ligjore e nënligjore, të ndryshuara shumë shpesh, informacioni mbi aktet ligjore në kohën e krizës së shkatuar nga Covid-19 ishte i pakuptueshëm, duke shkatuar konfuzion të madh jo vetëm në publik, por edhe mes profesionistëve të ligjit.

3.2.3. Informimi publik u cenua edhe në lidhje me veprimtarinë e gjykatave

a. Cenimi i parimit të gjyqit publik

Një problem i mprehtë gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkatuar nga Covid-19 ishte moslejimi i gazetarëve dhe publikut për të marrë pjesë në seancat gjyqësore. Me Aktin Normativ nr. 9, datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, gjykatat u mbyllën për rreth 2 muaj, deri më 29.05.2020, megjithatë, edhe pas rihapjes, seancat gjyqësore u zhvilluan pa praninë e personave të tjerë që nuk janë palë në proces. Në këtë mënyrë janë përjashtuar nga sallat e gjyqeve gazetarët, aktivistët, dhe publiku në përgjithësi.

Nëse kjo mangësi në informim në kohë reale, e nxitur për të mbrojtur shëndetin publik, do të ishte zgjidhur përmes publikimit të informacionit në faqet e internetit të gjykatave, situata do të ishte zbutur. Por, shumë prej gjykatave në vend nuk kanë një faqe interneti funksionale, ndërsa gjykata më e ngarkuar në vend, ajo e Tiranës, prej kohësh zbaton anonimizimin e të dhënave, me pasojë edhe mospublikimin e informacioneve për shkak të pamundësisë për të procesuar të gjithë vendimet. Procesverbalet e seancave gjithashtu nuk janë publike. Kjo situatë është krijuar për shkak të një urdhëri të Ministrisë së Drejtësisë nr. 4059/2, datë 07.06.2016 “Për anonimizimin e të dhënave personale të vendimeve gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave”. Ky udhëzim është mbështetur edhe në udhëzime të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për këto shkaqe të kombinuara bashkë, informimi për veprimtarinë gjyqësore gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 ka qenë i cenuar në mënyrë të ndjeshme, sidomos duke nisur prej datës 29 Maj 2020 e në vijim.

b. Pengesat për shqyrtimin e shpejtë të padive gjyqësore për marrjen e informacionit

Me Aktin Normativ nr. 9, datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, gjykatat u mbyllën për rreth 2 muaj, deri më 29.05.2020, që u rihapën përmes Aktit Normativ nr. 21, datë 27.05.2020 “Për disa ndryshime në aktin normativ nr.9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, miratuar me ligjin nr.30/2020.

Përgjatë periudhës 25 Mars 2020 deri më 29 Maj 2020, gjykatat, përfshirë Gjykatën Administrative, nuk zhvilluan seanca gjyqësore, duke afektuar dhjetëra çështje që lidheshin me të drejtën e informimit, të nisura kryesisht nga gazetarë të ndryshëm, sipas qendrës Res Publica, si A.R. (5 procese gjyqësore), M.D. (11 procese gjyqësore), L.Ç., etj dhe aktivistë të shoqërisë civile, si Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, të përfaqësuar nga Qendra Res Publica.

Në disa prej këtyre çështjeve, pas rifillimit të aktivitetit dhe përfundimin e periudhës së gjendjes së fakeqësisë, gjykatat vepruan sipas standardeve të Këshillit të Evropës dhe pranuan dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm (një procedurë e posaçme e bazuar në nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile, e cila siguron ekzekutimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, pavarësisht se nuk ka marrë formën e prerë dhe ndaj tij është bërë ankim). Kjo qasje e gjykatës ishte një zgjidhje shumë e mirë, por që funksionoi vetëm në 9 raste. Të gjithë rastet e tjerë kanë pësuar vonesa nga mbyllja e gjykatave dhe mosfunksionimi normal edhe pas hapjes së tyre. Lidhur me këtë në vijim shpjegohen më gjatë disa shembuj pozitivë të praktikës gjyqësore të ndjekur nga Res Publica.

4. VEPRIMTARIA E KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

4.1. Vlerësimi i punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit

Në rezolutën e Kuvendit më 28 Mars 2019, ky organ u shpreh:

“...veprimtaria e Komisionerit ka shënuar një përmirësim të ndjeshëm në zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit 119/2014...Kuvendi i Shqipërisë kërkon që zyra e Komisionerit për vitin 2019...të angazhohet veçanërisht dhe në këto drejtime...të monitorojë përditësimin e programeve të transparencës dhe regjistrat të kërkesave dhe përgjigjeve...të rrisë numrin e masave administrative për shkeljet ligjore të konstatuara me fokus të veçantë mungesën e programeve të transparencës dhe regjistrat të kërkesave dhe përgjigjeve...”

Një vit më vonë, në rezolutën e Kuvendit më 21 Maj 2020, ai shpreh:

“Ka realizuar plotësisht 12 rekomandimet e lëna në rezolutën e datës 28.03.2019 të Kuvendit të Shqipërisë. Ka prirje positive të rritjes së transparencës së autoriteteve publike...rritur me 60%...Ka përmirësim të ndjeshëm të nivelit të transparencës në 90% të rasteve në njësitë e vetëqeverisjes vendore... Kuvendi kërkon që Komisioneri për të Drejtën e Informimit... të angazhohet në... përmirësimin e programit model të transparencës... monitorimin dhe... marrjen e masave për krijimin dhe vënien në efikasitet brenda vitit 2020 të regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit”.

Kjo rezolutë e fundit u shoqërua me debat në seancën plenare të datës 21 Maj 2020, ku deputeti Ralf Gjoni ngriti shqetësime për vërtetësinë e shifrave në raport, duke sjellë shembuj të mosfunksionimit të të drejtës së informimit nisur nga eksperiencia e aktivistëve të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit dhe duke u referuar në raportin e publikuar nga qendra Res Publica për vitin 2019. Për shkak të debatit, deputeti Ralf Gjoni u penalizua me përjashtimin 10 ditë nga punimet e Kuvendit.

Për veprimin e mësipërm të Kuvendit, 10 organizata të shoqërisë civile, 2 grupe informale dhe 3 gazetarë investigues, shpërndanë një deklaratë për shtyp, ku ngriheshin problemet e

të drejtës së informimit. Në deklaratë i bëhej thirrje Kuvendit dhe faktorit ndërkombëtar që për të vlerësuar çështje të rëndësishme të marrin për bazë edhe burime alternative të raportimit, siç është shoqëria civile dhe të mos marrin për bazë vetëm burimet vetëvlerësuese të zyrave të shtetit si Komisioneri për të Drejtën e Informimit apo Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura në Kuvend, që janë potencialisht të kompromentueshme dhe rrjedhin nga procese jo transparente, potencialisht në shkelje të procedurave e parimeve të një shteti demokratik.


Gjatë vitit 2019, Komisioneri për të Drejtën e Informimit merrte mesatarisht rreth 65 ankesa në muaj. Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 Komisioneri ka marrë afro 50 ankesa në muaj, duke demonstruar se interesi i gazetarëve dhe aktivistëve ka vazhduar të mbetet i lartë, pavarësisht situatës së krijuar. Një pjesë e ankesave kanë pasur lidhje me informacion të drejtpërdrejtë me menaxhimin mjekësor të pandemisë, duke iu adresuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Institutit të Shëndetit Publik dhe spitaleve të ndryshme.

Në këtë vit, nisur edhe nga situata e krjuar, Komisioneri ka shtuar volumin e punës, krahasuar me një vit më parë, megjithëse rastet e trajtuara me vendim mbeten ende në një shifër të ulët, prej 5%.

Të dhënat e përpunuara më poshtë janë marrë pjesërisht nga faqja e internetit të Komisionerit, ndërsa pjesa tjetër është marrë nga përgjigjet e kërkesave për informacion drejtuar zyrës së tij.

a. Numri i vendimeve të marra nga Komisioneri


Fig. 1 - Numri i vendimeve të Komisionerit në vitet 2015 - 2020



Siç vihet re në grafik, pas një uljeje të vazhdueshme të numrit të vendimeve gjatë viteve të fundit, në këtë vit Komisioneri e ka rritur këtë numër. Nga 38 vendime në total (ku 3 vendime kanë të bëjnë me “programet e transparencës”), 24 prej tyre i përkasin periudhës së pandemisë Covid-19. Mbetet shqetësuese që përsëri mbi 90% e ankesave nuk trajtohen me vendim, pavarësisht se raportohet që në një masë të madhe rastet janë zgjidhur pa nevojën e një vendimmarrjeje. Cilësia e këtyre zgjidhjeve është në pikëpyetje.

b. Trajtimi i ankesave nga Komisioneri

Fig. 2 - Llojet e vendimeve të Komisionerit




Grafiku i mësipërm tregon se nuk ka ndryshime thelbësore në llojin e vendimmarrjes së Komisionerit. Përgjithësisht ankesat janë pranuar plotësisht ose pjesërisht, por bie në sy fakti që numri i ankesave të pranuar plotësisht është më i ulët në 5 vitet e fundit. Vlen të përmendet se këtë vit, Komisioneri ka marrë edhe 3 vendime nisur me iniciativën e vet, lidhur me transparencën proaktive, për 3 bashki (Ura Vajgurore, Rrogozhinë, Bulqizë), duke vendosur gjobë për titullarin e institucionit.


c. Kohëzgjatja e marrjes së vendimeve nga Komisioneri

Gjatë dy viteve të fundit (2019-2020), Komisioneri ka marrë pjesën më të madhe të vendimeve brenda afatit ligjor. Mesatarja e kohëzgjatjes këtë vit është 22.5 ditë kalendarike, shumë e ngjashme me atë të vitit të kaluar, prej 22 ditësh kalendarike, krahasuar me 57 ditë në 2018.

Fig. 3 - Kohëzgjatja e vendimmarrjes së Komisionerit




d. Numri i ankesave drejtuar Komisionerit

Fig. 4 - Numri i ankesave drejtuar Komisionerit në vite (2015 – 2020)

Nga krahasimi i të dhënave më sipër rezulton që numri i ankesave drejtuar Komisionerit për vitin 2020 është 715, një numër pak më i ulët ky, krahasuar me vitin 2019 kur numri arriti pikën më të lartë prej 786 ankesash. Kjo është në dukje një shenjë e mirë që edhe pse ka një ulje, interesi i kërkuesve ka qenë mjaftueshëm i lartë gjatë periudhës së pandemisë. Nga ana tjetër kjo shifër tregon transparencë problematike të organeve publike gjatë kësaj periudhe, sidomos kur vihet re se për herë të parë gazetarët kanë paraqitur më shumë ankesa se qytetarët e zakonshëm, siç e shohim në grafikun në vijim.

e. Subjektet që i janë drejtuar Komisionerit

Raporti i përmbysur i ankesave të gazetarëve apo aktivistëve të shoqërisë civile në krahasim me qytetarët e zakonshëm tregon për interesin e lartë për informim gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore dhe menaxhimit të saj nga autoritetet.

Fig. 5 - Kategoritë e subjekteve ankimues


Përmbysja e këtij raporti, ku gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile janë më shumë se gjysma e ankimesve, sugjeron tre shkaqe: e para kjo kategori është ajo që ka interes për të përdorur më shumë ligjin dhe më e interesuar për t'u informuar mbi aktivitetin e organeve publike; e dyta, kjo kategori është ajo që refuzohet më shpesh nga institucionet për shkak të informacionit sensitive që supozohet se kërkojnë, dhe për rrjedhojë është më aktive sa i takon ankimeve; dhe e treta kjo kategori është më këmbëngulëse në marrjen e informacionit, duke i ndjekur të rrugët ligjore.

Gjatë monitorimit është vënë re gjithashtu se një pjesë e mirë e gazetarëve investigativë “vuajnë” mos reagimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, i cili i ka çuar ata në disa raste të kërkojnë realizimin e të drejtës së tyre mes rrugës gjyqësore që u kushton energji, mjete monetare dhe kohë.

Nisur nga interesimi i lartë i gazetarëve dhe organizatave jo fitimprurëse, Komisioneri për të Drejtën e Informimit duhet të krijojë kapacitetet e duhura që të trajtojë me shpejtësi ankesat e kësaj kategorie. Kjo jo vetëm për shkak të rritjes së vazhdueshme të ankesave të bëra nga kjo kategori, por edhe për rëndësinë që ka informacioni në veprimtarinë e tyre. Kujtojmë këtu se mes garantimit të së drejtës së tyre për t'u informuar, garantohet një komunikim më i plotë në zbatim të lirisë së shprehjes dhe publiku informohet pa humbur kohë, pasi gazetarët dhe aktivistët e shoqërisë civile informacionin që marrin nuk e kanë për përdorim vetjak, por për ta përpunuar dhe shpërndarë te publiku.

f. Trajtimi i ankesave nga Komisioneri

Fig. 6 - Trajtimi i ankesave nga Komisioneri në vitet 2019-2020




Siç shihet në grafikun e mësipërm, pjesa më e madhe e ankesave zgjidhen pa një vendim të Komisionerit. Ky i fundit pretendon që këto raste janë zgjidhur, por siç e shpjegojmë edhe në vijim, ka shumë raste të raportuara nga gazetarët që nuk i kanë parë këto si “zgjidhje”, pasi nuk kanë marrë informacionin e kërkuar. Shumë raste kanë përfunduar në gjykatën administrative, megjithëse Komisioneri i ka konsideruar të “zgjidhura”. Vihet re gjithashtu që vijon një numër i lartë i ankesave të bëra jashtë objektit të ligjit, nga qytetarë që nuk kanë ide të qarta mbi të drejtën e informimit.

g. Aplikimi i sanksioneve

Gjatë vitit 2020 Komisioneri për të Drejtën e Informimit nuk ka vendosur asnjë sanksion me gjobë për ankesat e pranuar, lidhur me refuzimin e informacionit. Të vetmet gjoba të vendosura nga kjo zyrë janë ndaj 3 bashkive të vogla që nuk kanë zbatuar detyrimin për programet e transparencës. Nuk bëhet e qartë si është bërë përzgjedhja e këtyre bashkive, ndërkohë që programet e transparencës nuk janë plotësura nga një numër i madh bashkish.

Interesant është fakti se Komisioneri ka mbajtur qendrim ndryshe për ankesat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat janë të gjitha të pranuar dhe të shoqëruara me gjoba.

Fig. 7 - Aplikimi i sanksioneve nga Komisioneri



4.2. Vlerësim i treguesve cilësorë të transparencës dhe ndikimi i Komisionerit

Siç vihet re, treguesit sasiorë nuk kanë luhatje domethënëse në kuptimin statistikor, por është e rëndësishme të theksohet se mosfunksionimi i ligjit në periudhën e krizës ka goditur më së tepërmi gazetarët investigues, të cilët dëshmojnë për pengesa serioze në aksesin në informacionin publik.

Gjatë periudhës së krizës së shkaktuar nga Covid-19, disa gazetarë konfirmojnë se gjatë kësaj kohe kanë kërkuar informacione, por nuk kanë marrë përgjigje në pjesën dërmuese të rasteve. Përveç gazetares investigative L.Ç. e cila ka kontaktuar direkt me qendrën Res Publica për këtë problematikë, ka edhe raste të bëra publike në media. Për shembull, për qendrën Faktoje (një organizatë që kryen veprimtarinë e vëfrimit të fakteve), e drejta e informimit është vështirësuar gjatë pandemisë Covid-19.

“Në disa prej sektorëve më të rëndësishëm që janë në përballje të parë me pandeminë, kryesisht me shëndetësinë dhe me fondet publike, që i akordohen emergjencës, me mënyrën se si reagon dhe si vepron pushteti vendor, mungesa e informacionit është e theksuar, burokracia në kuptimin më klasik të fjalës është jo vetëm penguese, por edhe sorollatëse dhe nuk jepet e nuk vihet në dispozicion informacioni i kërkuar” – shprehet kryetari i Unionit të Gazetarve Shqiptarë, Aleksandër Çipa.

Sipas këshilltares ligjore pranë Qendrës Europiane për Lirinë e Shtypit me bazë në Gjermani, Flutura Kusari, gjatë pandemisë, qeveria ka qenë shumë pak transparente. Në vend që të

organizoheshin konferenca të rregullta për shtyp, në vend që gazetarëve t'u ofrohej mundësia për të bërë pyetje, por edhe t'u ofrohejshin dokumenta të cilat dëshmojnë se si menaxhohet pandemia, kemi parë të kundërtën. Kemi parë që dokumentet e kërkuara nga organizatat joqeveritare, përfshirë “Faktoje”, nuk janë dhënë duke shfrytëzuar shpeshherë ose heshtjen administrative ose duke mos dhënë fare përgjigje,— shprehet zonja Kusari.

Nga 35 kërkesa për informacion të dërguara nga organizata “Faktoje”, institucionet u përgjigjën vetëm në 6 raste brenda afatit ligjor dhe në 2 raste, pas ankimit te Komisioneri për të Drejtën e Informimit.

Ka pasur ankesa jo vetëm nga organizata ose gazetarë që përdorin të drejtën e informimit për të mbledhur informacion, por edhe nga organizata të tjera të shoqërisë civile, që kanë kërkuar informacion nga Ministria e Shëndetësisë për aspekte të pandemisë, ose të sistemit shëndetësor që lidheshin direkt me përgjigjen që ato kishin ndaj pandemisë “Covid-19”. Ka pasur ankesa nga Organizata e të Drejtave të Pacientëve se Ministria e Shëndetësisë nuk i jepte informacion për numrin e respiratorëve që ndodheshin në vend në fillimin e pandemisë – shprehet Besar Likmeta nga rrjeti investigativ BIRN.

Të gjitha ankesat e gazetarëve të cituar më sipër do të duhej të ishin trajtuar me vendimmarrje nga ana e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, i cili rezulton se këtë vit ka marrë vendim vetëm për 5% të ankesave dhe nuk ka aplikuar asnjë sanksion me gjobë, në një kohë kur informacioni, sidomos ai që lidhet me pandeminë, është tepër i rëndësishëm për t'u aksesuar nga gazetarët dhe publiku në një kohë sa më të shpejtë. Treguesit sasiorë nuk janë të përshtatshëm për t'u marrë si bazë e vetme e suksesit apo dështimit, por i duhet kushtuar edhe një vëmendje e veçantë kërkesave specifike nga gazetarët, për të cilët treguesit sasiorë nuk kanë domethënie.

4.3. Praktika të tjera të Komisionerit për të Drejtën e Informimit

a. Urdhërat administrativë të Komisionerit

Në fund të vitit 2020 Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka nxjerrë dy urdhëra; një për modelin e programit të transparencës dhe një për modelin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.

Vihet re se modeli i ri i programit të transparencës, paraqitet i organizuar më mirë dhe lehtësisht më i përdorshëm (user friendly). Pavarësisht kësaj, edhe ky model njësor si i mëparshmi, nuk është i personalizuar sipas llojit të veprimtarisë së institucioneve. Për shembull, ky model nuk është i përshtatshëm për institucionet që mbulojnë fushën e mjedisit, pasi legjislacioni përkatës i tyre parashikon detyrime të posaçme për informimin e publikut, një element që nuk përfshihet në këtë model. E njëjta gjë vlen edhe për institucione të tjera me fushë veprimtarie të veçantë.

Për sa i takon modelit të ri të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve që autoritetet do duhet të përshtasin sipas Urdhërit të Komisionerit, vihet re se këtu është shtuar rubrika e përgjigjes së dhënë nga institucioni, gjë të cilën e vlerësojmë si progres, por nga ana tjetër duket e gabuar zgjedhja e Komisionerit për të shtuar një rubrikë ku do të shënohet tarifa e dhënies së informacionit. Vendosja e “tarifës” për marrjen e informacionit është e gabuar dhe bie ndesh

me ligjin për të drejtën e informimit, i cili parashikon dhënien e informacionit publik pa pagesë, ose në raste të veçantë, me “kosto”. Në vend të tarifës duhet të parashikohet kostoja e përgatitjes së informacionit. Kjo kosto mund të përcaktohet nga Komisioneri, sipas një vlerësimi të këtij të fundit, me qëllim shmangien e vendosjes së tarifave abuzive nga ana e organit publik, si dhe për t’i unifikuar ato. Nga praktika e deritanishme është vënë re se disa institucione praktikojnë tarifa për dhënien e informacionit e cila e tejkalon disa herë koston e riprodhimit material të informacionit, si për shembull Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës.

b. Përpjekjet për anonimizimin e vendimeve gjyqësore kundër frymës së Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Përpjekjet për anonimizimin e vendimeve gjyqësore kanë një histori më të hershme dhe së fundi Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale po konkretizon një Udhëzim të ri, ende në formën e një drafti me titull “Për mënyrën e publikimit të vendimeve gjyqësore në portalin elektronik të gjykatave si dhe në faqet zyrtare të internetit të gjykatave.”

Titulli i aktit sugjeron idenë që objekti është rregullimi i publikimit të vendimeve gjyqësore, por në brendësi objekti i vërtetë është kufizimi i mënyrës së publikimit të këtyre vendimeve në faqet e internetit të gjykatave.

Në parim ky udhëzim përfaqëson një ndërhyrje në një të drejtë kushtetuese dhe është e nevojshme të theksohet që ajo mund të kufizohet vetëm me ligj. Për këtë arsye është në pikëpyetje baza ligjore përkatëse nëse ajo funksionon vërtet si një normë referuese për të lejuar një akt nënligjor të legjitimojë një ndërhyrje në këtë të drejtë.

Ky draft paraqet disa probleme, si më poshtë:

a. Nuk merr parasysh parimin e open justice (drejtësisë së hapur), sipas të cilit veprimtaria gjyqësore është e hapur, përveç rasteve përjashtimore.

Parimi kryesor është që *rregulli* është aksesimi në veprimtarinë gjyqësore (aksesi në dosje dhe në vendim), ndërsa *përjashtimi* vlen vetëm në raste të caktuara. Drafti në fjalë udhëhiqet nga parimi i kundërt, që aksesimi në veprimtarinë gjyqësore është një përjashtim dhe jo rregull. Kjo reflektohet në tërësinë e draftit. Që me krijimin e gjykatave, ato u krijuan me idenë e të qenit publike. Vetë emri i tyre sugjeron fjalën “oborr”, pra gjyqet në vende të hapura. Ky parim është trupëzuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 146, pika 2 e cila sanksionon detyrimin pozitiv të shtetit që “Vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast”.

Të njëjtin qëndrim mban edhe GJEDNJ, ku në një gjykim të fundit, lidhur me çështjen *Dadashbeyli kundër Azerbajxhanit* (3 dhjetor 2020), ku palë e tretë ishte qendra Res Publica, në paragrafin 24 thekson se:

“...zhvillimi i seancave publike mbron parimin themelor të nenit 6, paragrafi 1. Karakteri publik i procedimit mbron palët ndërgjyqëse kundër administrimit të drejtësisë në fshehtësi, pa vëzhgim publik; është gjithashtu një nga mjetet me të cilat mund të ruhet besimi në gjyqësor. Administrimi i drejtësisë në publik i jep asaj legjitimitet. Duke e bërë administrimin e drejtësisë transparent, publiciteti kontribuon në përmbushjen e qëllimit të nenit 6, paragrafi 1, përkatësisht një gjykim të drejtë, garantimi i të cilit është

një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike, brenda kuptimit të Konventës (sibih Boshkoski k. Maqedonisë së Veriut, nr. 71034/13, § 39, 4 qershor 2020, për referenca të mëtejshme). Ekziston një pritshmëri e lartë për publicitet në procedurat e zakonshme penale, të cilat mund të shqetësojnë individë të rrezikshëm...”

b. I jep administratës gjyqësore kompetenca që duhet t'i ketë gjyqtari (sipas kodeve të procedurave)

Kodet e procedurave, në frymën e parimit të sipërcituar, mes dispozitave të gjyqit apo seancës me dyer të mbyllura, kanë rregulluar ato raste kur përjashtimisht duhet të sakrifikohet transparenca me qëllim mbrojtjen e privatësisë apo të dhënave personale. Për këto raste ligjvënësi i ka lënë detyrë dhe diskrecion gjyqtarit, i cili për shkak të njohjes me detajet çështjes ka mundësinë të vlerësojë nëse duhet të “sakrifikohet” transparenca apo jo. Ky udhëzim krijon një ndërhyrje në këtë diskrecion të gjyqtarit.

c. Pengon avokatët, gazetarët dhe studiuesit në ushtrimin e funksioneve të tyre

Në nenin 10 të draftit parashikohen rastet përjashtimore të aksesit të plotë në vendime dhe dosje gjyqësore. Në këtë kategori, përvec palëve dhe mbrojtësve të tyre, renditen sipas pikës 6 edhe personat që për arsye studimi, shkencore, statistikore mund të kenë akses. Fillimisht theksojmë nevojën që në këtë pikë duhet të përfshihet edhe gazetari si profesionisti që informacionin e marrë gjatë aksesit në dosje dhe vendime gjyqësore e kërkon për interes publik. Kujtojmë këtu se gazetari mund të bëhet vetë mbajtës dhe mbrojtës i të dhënave personale (kontrollues i të dhënave), pikërisht për të garantuar anonimitetin në rastin eventual, duke pasur mundësi të mos cenohet intersi publik (përmes aksesit në dosje nga ana e tij).

Në një dispozitë listohet e drejta për akses në dosje të avokatëve që janë përfaqësues të palëve në çështje, por përjashton të drejtën për informim të avokatëve të tjerë që kanë interesa të lidhura me çështjen. Aksesit i avokatëve në përgjithësi në çdo dosje gjyqësore edhe kur nuk është palë vetë, është e domosdoshme për të rritur efikasitetin dhe profesionalizimin në punën e tij/saj dhe mbrojtjen e të drejtave të palëve që përfaqëson. Një avokati i duhet të marrë një provë e cila gjendet në një dosje tjetër gjyqësore ku klienti i vet nuk është palë (për shembull në një vendim për masë arresti kur vlerësimi i masës është i lidhur me një dosje tjetër). Një avokati i duhet të këshillojë klientin e vet nëse duhet të ndërhyjë në një proces gjyqësor që zhvillohet me palëve të tjera (ndërhyrja kryesore apo dytësore sipas neneve 189-191 të Kodit të Procedurës Civile), të cilat vetë avokati dhe pala që përfaqëson nuk ka si të ushtrojë këtë të drejtë nëse nuk ka akses në informacion.

Sistemi jonë ligjor në shumë aspekte ka rudimente të një sistemi inkuizitor (në kuptimin procedural penal) ku avokati ka një rol të reduktuar në hetimin për interesa të klientit të tij. Në shumë vende të Evropës, avokati nuk kufizohet në akses në informacion, edhe në rastin e të dhënave sensitive si të dhënat bankare, hipotekore, apo të dhëna kontraktuale të tjera, pikërisht për të realizuar më mirë mbrojtjen e interesave të ligjshme të palëve që përfaqëson. Garancia që mund të shoqërojë këtë të drejtë të avokatëve është që ata mund të konsiderohen si kontrollues të të dhënave, me pasojë detyrimin për të mos publikuar të dhëna jashtë ushtrimit të të drejtave procedurale dhe të themelit të palëve që përfaqëson.

Sa më sipër janë disa argumente që e bëjnë të diskutueshëm draftin e Udhëzimit dhe eventualisht objekt të kundërshtimit në rrugë gjyqësore.

c. Nisja e procedurave për ratifikimin e Konventës së Tromsos

Konventa 205/2009 e KiE është dokumenti më i ri ndërkombëtar në fushën e të drejtës së informimit. Ajo ka hyrë në fuqi në muajin Dhjetor 2020, pasi u ratifikua nga 10 shtete. Shqipëria, së bashku me shumë shtete të tjerë nuk e ka ratifikuar ende këtë instrument. Pozitiv është fakti që procesi i ratifikimit ka nisur. Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka hartuar projektligjin “Mbi aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën nr. 205/2009, të Këshillit të Evropës, “Mbi aksesin në dokumentet zyrtare””. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1123, datë 30.12.2020, u miratua në parim Konventa e KiE “Për aksesin në dokumentet zyrtare” dhe pritet të cohet para nëpërmjet procedurave deri në nënshkrimin dhe ratifikimin e saj.

Pavarësisht se dispozitat e Konventës në fjalë janë të përmbushura në përgjithësi nga ligji vendas, me rëndësi janë dy faktorë kryesorë:

- a. Përmbushja e detyrimit për të krijuar procedura të përshpejtuara gjyqësore për aksesin në informacion.
- b. Vendosja e një detyrimi shtesë për të raportuar për zbatimin e të drejtës së informimit ndaj organeve të Konventës, duke shtuar seriozitetin e raportimit dhe mundësinë e shoqërisë civile të advokojnë përmes inputeve në monitorimin dhe vlerësimin e këtyre raporteve.

d. Projektligji mbi të dhënat e hapura dhe ri-përdorimin e informacionit të sektorit publik në proces miratimi

Si pasojë e zhvillimit të formateve digjitale, sot në botë është rritur në masë të jashtëzakonshme sasia e të dhënave, përfshirë edhe të dhënat publike. Në këto kushte, kur përparimi teknologjik ka ecur me hapa galopante, koncepti “të dhënat e hapura - open data” është domosdoshmëri të rregullohet edhe nga legjislacioni shqiptar. Kjo vjen edhe në përputhje me standardet e BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Kjo është premisë nga buron nevoja e një rregullimi normativ, gjë e cila është realizuar me propozimin e projektligjit “Mbi të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”. Projektligji krijon hapësira që autoritetit publik t’i shtohet një detyrë e re, që është mbrojtja, mbikëqyrja, garantimi dhe promovimi i së drejtës për ripërdorimin e informacionit publik. Iniciativa ligjore është ndërmarrë nga Zyra e Komisionerit dhe është përafruar me Direktivën e BE 2019/1024 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”. Projektligji pritët të shqyrtohet nga Komisionet Parlamentare, para miratimit në Kuvend.

e. Lidhur me proceset gjyqësore

Në raportin e veprimtarisë për vitin 2020, Zyra e Komisionerit i ka kushtuar një kapitull të veçantë ecurisë së proceseve gjyqësore. Sipas këtij dokumenti, raportohet se kjo zyrë “ka ndjekur në total 35 procese gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Për periudhën raportuese, u ndoqën 30 procese gjyqësore me objekt ligjin për të drejtën e informimit, ndër të cilat: 6 çështje administrative janë ndjekur për vendime të dhëna në vitin 2020, 17 çështje janë ndjekur për akte administrative, 2 çështje administrative janë ndjekur për vendime të dhëna nga Komisioneri në vitin 2019 dhe 5 procese gjyqësore janë

të mbartura. Nga 30 procese gjyqësore, gjykata ka vendosur për 6 çështje lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit, në 3 raste pranimin e kërkesë padisë, 7 pranime të pjesshëm të padisë, në 10 raste pushimin e gjykimit për Zyrën e Komisionerit me kërkesë të palës paditëse me argumentin se institucioni ka përmbushur funksionin e tij administrativ, ndërsa 4 çështje vijojnë të jenë në proces.²⁰

Ajo që bën përshtypje është raportimi për pushimin e 10 proceseve gjyqësore ndaj kësaj zyre me argumentin se institucioni ka përmbushur funksionin e tij administrative. Nga monitorimi i këtyre çështjeve rezulton se nga këto 10 çështje, në të paktën 5 prej tyre, me palë paditëse gazetarin M.D., pushimi i gjykimit është bërë nga paditësi për ekonomi gjyqësore dhe jo sepse Komisioneri ka përmbushur detyrën e vet (siç shprehet raporti), që duhej të ishte dalja me një vendim nga ana e kësaj zyre. Siç e kemi theksuar në cdo raport, praktika e Komisionerit për të mos marrë vendime për çdo ankesë është një praktikë e gabuar dhe jo efektive e kësaj zyre. Kjo gjë është theksuar tashmë në çdo vendim të gjykatës administrative kur ndaj Komisionerit është ngritur pretendimi që kjo zyrë duhej të kishte marrë një vendim.

Vetëm gjatë vitit 2020 ka të paktën 4 vendime që argumentojnë se Komisioneri nuk e ka përmbushur detyrën e vet në çdo rast kur nuk ka marrë një vendim lidhur me një ankese, qoftë ky vendim pranimi apo vendim rrëzimi. Madje në një nga çështjet zyra e Komisionerit është ngarkuar me një dëmshpërblim edhe pse në vlerë simbolike, pikërisht për shkak të mosmarrjes së një vendimi pas ankimimit. Në çdo rast zyrës së Komisionerit i janë ngarkuar shpenzimet gjyqësore lidhur me rastet kur ai është paditur për mosmarrje vendimi, por në vend të tyre ka preferuar zgjidhjet e ashtuquajtura “zgjidhje me pajtim” apo zgjidhje të ankimimit mes shkresave të thjeshta, jo në formë vendimi.²¹

Qasja e Komisionerit, duke injoruar në vijim praktikën tashmë të konsoliduar të gjykatës administrative që kërkon nga kjo zyrë marrjen e një vendimi pas ankimimit, tregon për mungesë reflektimi nga ana e kësaj zyre. Shembulli më sipër tregon se në raportimet e veta Komisioneri i bën kozmetikë fakteve për ta paraqitur realitetin ndryshe, duke vënë në dyshim vetë raportin vjetor. Shembull tjetër i kësaj “kozmetike” është edhe raportimi i 7 çështjeve me pranim të pjesshëm të padisë. Ky fakt, sipas monitorimit të bërë nga Res Publica që ka ndjekur çështjet gjyqësore, rezulton se “pranimi i pjesshëm i padisë” nuk lidhet me veprimtarinë e Komisionerit, por me: (1) rastet kur është kërkuar dëmshpërblim nga paditësi për mosdhënie informacioni dhe gjykata ka rrëzuar dhënien e dëmshpërblimit, por jo pjesën tjetër e cila lidhet me dhënien e informacionit të plotë dhe mos marrjen e vendimit nga Komisioneri; dhe (2) rastet kur gjykata ka pranuar pjesërisht padinë për një pjesë të informacionit që e ka konsideruar konfidencial, dhe në këto raste Komisioneri sërish nuk ka trajtuar ankesat me vendimarrje siç e kërkon ligji.

f. Bashkëpunimi me shoqërinë civile

Në kuadër të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile gjatë vitit 2020 u realizuan disa aktivitete me fokus forcimin e të drejtës për informim, si:

20 Shih raportin vjetor të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2020, i aksesueshëm në:
https://www.idp.al/wp-content/uploads/2021/03/Raporti_IDP_2020.pdf

21 Shih raportin e qendrës Res Publica për të drejtën e informimit për vitin 2019, i aksesueshëm në:
<http://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2020/01/E-drejta-e-informimit-2019-Res-Publica-web.pdf>

- takime me përfaqësues të organizatave “Together for Life”, “Birn Albania”, “Faktoje.al”, “Qendresa Qytetare”, “Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim”, ku u diskutuan problematika në lidhje me transparencën dhe kontributin e shoqërisë civile në këtë drejtëm;
- bashkëpunim me shoqatën “Lëviz Albania” për të zhvilluar webinar-in me përfaqësuesit e shoqërisë civile me temë “Programi i Transparencës: element ndërlidhës mes Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe aktorëve të shoqërisë civile për forcimin e demokracisë vendore”;
- bashkëpunim me “Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim” për t’u prezantuar përfaqësuesve të shoqërisë civile raportin e monitorimit “Vlerësimi i Transparencës dhe Llogaridhënies në Bashkitë Elbasan, Lezhë, Durrës, Kukës, Fier, Gjirokastrë, Tiranë dhe Shkodër”;
- institucioni u bë pjesë e fokus grupit në kuadër të projektit “Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të sigurisë, mekanizmave monitories dhe shoqërisë civile”, organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

Qendra Res Publica nuk ka pasur ftesë për të diskutuar çështjet e mprehta të të drejtës së informimit, pavarësisht se është organizata që monitoron çdo vit këtë veprimtari, si dhe paraqet numrin më të madh të ankesave, proceseve gjyqësore, etj. Përkundrazi, në muajin Janar 2020, zyra e Komisionerit, pasi abandonoi konferencën vjetore që Res Publica organizon për të drejtën e informimit, ka pasur një shkëmbim të ashpër me email me qendrën Res Publica, për shkak se Komisioneri nuk u rendi i pari në renditjen e transparencës dhe çmimin vjetor Res Publica ia akordoi Bashkisë Shkodër.

Madje, në një aktivitet online të Komitetit Shqiptar të Helsinkit më 14 Dhjetor 2020, në përpjekje për të delegjitimuar të dhënat kritike të raportit të qendrës Res Publica për të drejtën e informimit për vitin 2019, Komisioneri e ka përçmuar raportin, pa ndonjë referencë faktesh objektive, por duke bërë komente negative mbi kopertinën e raportit që sipas tij nuk ia vlente të diskutohej më tej.

Qendrimi i Komisionerit ndaj qendrës Res Publica, e cila publikon raporte kritike, është një tregues i një bashkëpunimi selektiv, që nuk i shërben interesave të vetë Zyrës së Komisionerit.

5. TRANSPARENCA E INSTITUCIONEVE


5.1. Reagimi i institucioneve ndaj kërkesave për informacion

Për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për testimin e sjelljes së institucioneve ndaj kërkesave për informacion janë marrë në konsideratë 157 kërkesa për informacion dërguar për 13 kategori të ndryshme informacioni, të cilat kanë ndjekur një rrugëtim të plotë administrativ dhe nuk janë afektuar nga vonesat e shkaktuar prej vetë stafit të qendrës Res Publica.

a. Reagimi i institucioneve ndaj kërkesave fillestare

Situata e sjelljes së institucioneve ndaj kërkesave fillestare për vitin 2020, krahasuar me vitin paraardhës, paraqitet si më poshtë:

Fig. 8 - Kthimi i përgjigjeve ndaj kërkesës fillestare



Gjatë vitit 2020, me gjithë efektet e pandemisë që shoqëroi pjesën më të madhe të tij, kërkesat fillestare për informacion kanë marrë përgjigje të plota në 60% të rasteve, me ndryshim të papërfillshëm në krahasim me situatën normale të vitit të kaluar. Këto shifra tregojnë se kur autoritetet kanë vullnetin të përgjigjen, e bëjnë këtë edhe në kushtet e fatkeqësisë natyrore.


Megjithatë ajo që vlen të theksohet është se numri i përgjigjeve nuk tregon domosdoshmërisht transparencë dhe përgjegjshmëri, nëse kjo nuk ndodh në rastin e informacioneve me ndjeshmëri të lartë që kërkohen nga gazetarët në lidhje me krizat e momentit. Nga intervista me gazetarët investigativë rezulton se informacionet lidhur me krizën nuk kanë gjetur përgjigje, çështje të cilën e trajtuam në kapitujt më sipër.

Një rënie e lehtë vihet re në kthimin e përgjigjeve të pjesshme duke rritur numrin e refuzimeve gjatë vitit 2020, në shifrat më të larta në 4 vitet e fundit.

b. Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave fillestare

Në lidhje me kohëzgjatjen e kthimit të përgjigjes ndaj kërkesës fillestare, situata paraqitet si më poshtë:

Fig. 9 - Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes pas kërkesës fillestare



Ky tregues rezulton se nuk ka ndryshim të ndjeshëm në krahasim me vitin e kaluar (në kohë normale) dhe duket se situatat e fatkeqësive natyrore nuk kanë ndikuar në kohëzgjatjen e kthimit të përgjigjeve. Megjithatë, vlen për të theksuar se Res Publica është një organizatë që njihet për insistimin në kërkimin e informacioneve, duke shfrytëzuar të gjitha rrugët administrative e gjyqësore dhe ky faktor mund të ketë ndikuar për t'i dhënë përparësi në raport me gazetarët.

Sipas qendrës Faktoje, vetëm një përqindje e vogël e kërkesave për informacion kanë marrë përgjigje gjatë pandemisë Covid-19, duke demonstruar një qasje ndryshe ndaj subjekteve të tjerë.

Theksojmë gjithashtu se afati ligjor prej 10 ditësh pune (zakonisht 14 ditë kalendarike) është afati maksimal dhe pritshmëritë janë që ky afat maksimal të aplikohet në raste të veçanta dhe kur çështja paraqet kompleksitet, e jo të tejkalohej rregullisht.


Edhe në dy vitet e kaluara situata ishte larg optimale, pasi kthimi i përgjigjeve edhe në kohë normale ka qenë përtej afatit ligjor (26 ditë në vitin 2018 dhe 24 ditë në vitin 2019). Pandemia nuk ka ndikuar për ta bërë edhe më të gjatë këtë kohëzgjatje, për arsye se viti krahasues ishte vetë përtej kohëzgjatjeve të arsyeshme.

I vetmi mjet efektiv që do të siguronte respektimin e afatit ligjor nga institucionet është në kompetencën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, i cili edhe në vitet e kaluara nuk ka marrë masa në këtë kontekst.

c. Reagimi i institucioneve pas dorëzimit të ankimit administrativ

Reagimi i institucioneve pas dorëzimit të ankimit administrativ paraqitet si më poshtë:

Fig. 10 - Përqindja e përgjigjeve pas dorëzimit të ankimit administrativ



Nga grafiku i mësipërm vihet re se kemi një rritje të lehtë të reagimit në këtë fazë, krahasuar me vitin e kaluar. Niveli i lartë i dhënies së informacionit pas ankimit administrativ tregon se Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka pasur mjaftueshëm autoritet në trajtimin me seriozitet të kërkesave për informacion.


Shifra e këtij viti, megjithë gjendjen e pandemisë, është më e lartë se vitin e kaluar dhe pak më e ulët se në vitin 2018, kur nuk ka pasur asnjë krizë. Edhe rënia e vitit 2019 është shënuar më së shumti gjatë zgjedhjeve vendore dhe jo në periudhën e fatkeqësisë natyrore të shkatuar nga tërmeti i 26 Nëntorit.

d. Kohëzgjatja e reagimit të institucioneve pas ankimit administrativ

Kohëzgjatja e reagimit të institucioneve pas ankimit administrativ, para se Komisioneri të marrë një vendim, është matur për të parë edhe në këtë hallkë kohën e reagimit të institucioneve. Kjo matje i shërben një panorame më të plotë të rrugëtimit administrativ të kërkesave për informacion dhe si ka ndryshuar kjo situatë gjatë viteve dhe në veçanti, në krahasim me situatën e jashtëzakonshme të vitit 2020.

Të dhënat e mbledhura tregojnë se se kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes së institucioneve pas ankimit administrativ të Komisioneri është ulur me 2 ditë kalendarike gjatë vitit 2020.

Fig. 11 - Kohëzgjatje e kthimit të përgjigjes pas dorëzimit të ankimit administrativ




5.2. Vlerësimi i transparencës proaktive sipas treguesve të zakonshëm

a. Programet e transparencës

Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” parashikon detyrimin e autoriteteve publike që të publikojnë disa lloje informacionesh pa pasur nevojë për ta kërkuar atë në mënyrë aktive. Res Publica monitoroi 100 autoritetet publike më të rëndësishme në vend, të ndara në pesë kategori: (1) institucione kushtetuese dhe të pavarura; (2) institucione qendrore të pushtetit ekzekutiv; (3) institucione të varësisë së pushtetit ekzekutiv; (4) institucione të pushtetit vendor; (5) institucione të drejtësisë.

Fig. 12 - Përmbushja e programeve të transparencës



Nga të dhënat më sipër, rezulton se në vitin 2020 nuk ka asnjë ndryshim në cilësinë e përmbushjes së programeve të transparencës. Situata ka qenë shumë problematike edhe para gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe ka vijuar e njëjtë edhe gjatë situatës së krijuar nga Covid19 gjatë muajve Mars 2020 e në vijim.


Një e katërta e institucioneve kryesore janë pa program transparence. Pjesa dërmuese e tyre kanë përmbushur pjesërisht programet e transparencës (me më pak se gjysmën e informacionit sipas kërkesave të ligjit) dhe vetëm 1/5 e institucioneve kanë përmbushur disi më mirë programet e transparencës, duke publikuar mbi 50% të informacionit. Është konstatuar edhe më herët se progresi në lidhje me këtë aspekt është frenuar në shifra mediokre, të tilla sa nuk vihet re asnjë përmirësim për të përballuar nevojat e transparencës gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Niveli i përgjithshëm i matur i indeksit të transparencës proaktive (matur nga qendra Res Publica gjatë vitit 2019) mbetet në nivelin 25.4%, pa u ndikuar nga gjendjet e fatkeqësive natyrore.

Në këtë kuptim vihet re se vijon duke mos publikuar informacione me rëndësi si për shembull, monitorimi e kontratave të prokurimit publik. Shpesh linqet nuk janë funksionale, ose referojnë në informacione të papërditësuara prej kohësh.

b. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

Fig. 13 - Përmbushja e regjistrave të kërkesave dhe përgjigjeve



Rezulton se institucionet që kanë përmbushur këtë kërkesë të ligjit vijnë të mbeten korrektë edhe gjatë periudhave të fatkeqësive natyrore, megjithëse numri i këtyre institucioneve është tepër i vogël. Ndërsa për institucionet e tjerë, situata duket se ka një përkeqësim, duke u shtuar kategoria që nuk kanë publikuar regjistrë dhe duke vijuar me trendin rënës të nisur që nga viti 2018. Në këto kushte situata me regjistrat është bërë shumë alarmante.

c. Koordinatorët për të drejtën e informimit

Nuk ka ndryshim as në nivelin e caktimit të koordinatorëve për të drejtën e informimit, i cili mbetet në masën 73% dhe nuk ka asnjë marrje masash në këtë drejtim.

6. LITIGIME STRATEGJIKE DHE GJATË 2020 DHE ASPEKTE TE VECANTA QE PREKIN TE DREJTEN E INFORMIMIT

Pas ankimimit të refuzimit të informacionit, mjeti ligjor që mbetet në duar të kërkuësve është rruga gjyqësore. Zakonisht çështjet për kërkimin e informacioneve sensitive nisen nga gazetarët dhe aktivistë të shoqërisë civile. Vlen të theksohet se gjykata, si instancë e fundit, ka treguar relativisht një cilësi të mirë të vendimmarrjes. Edhe këtë vit gazetarët kanë përfituar nga vendimet e gjykatës dhe në vijim jepen disa raste gjyqësore që trajtojnë aspekte të veçantë.

6.1. Kompensimi i dëmit jopasuror të shkaktuar nga refuzimi i informacionit, risi për jurisprudencën shqiptare

Kompensimi për dëmin jopasuror është një e drejtë e njohur nga Kodi Civil. Teorikisht ky kompensim i njëjti edhe kërkuësve të informacionit publik që nga ligji nr. 8503, dt. 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit mbi dokumentat zyrtarë”. Sipas nenit 17 të këtij ligji, çdo person, i cili ka pësuar një dëm për shkak të cenimit të së drejtës për informim ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar. Edhe në ligjin e ri nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” parashikohet kjo e drejtë. Edhe pse kjo e drejtë teorikisht është njohur për më shumë se 20 vjet, në gjykatat Shqiptare nuk ka pasur asnjë çështje me kërkesë për dëmshpërblim, për shkak të mungesës së modaliteteve lidhur me plotësimin e elementëve të duhur për të provuar ekzistencën e dëmit, kuantifikimin e tij dhe lidhjen shkak-pasojë.

Për herë të parë, në rastin e gazetarit A.R., i përfaqësuar nga avokatë pranë qendrës Res Publica, në çështjen kundër Agjencisë së Burimeve Natyrore dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë pranoi në parim ekzistencën e dëmit të shkaktuar gazetarit dhe përgjegjësinë e dy institucioneve AKBN dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Gjykata pranoi se meqenëse është hera e parë, të japë një kompensim simbolik si dëm punitiv, në vlerën 1 lek, por me premisën se ky veprim nuk duhet të përsëritet. Gjykata pranoi gjithashtu ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore palëve të paditura në një masë 180.000 lekë, shpenzime të bëra kryesisht për pagesën e ekspertëve.

Kjo është praktika e parë gjyqësore që njeh dëmin dhe shërben si paralajmërim për organet e administratës, të cilat në raste të refuzimit mundet të paguajnë edhe dëmshpërblim në vlera më serioze.

Duhet theksuar se kompensimi për dëmin jo pasuror nuk është praktikë e zhvilluar në përgjithësi në vendin tonë krahasuar me vende të tjera, pavarësisht teorisë që ka ecur shumë më përpara dhe krah vendeve të zhvilluara. Përveç rasteve kur e drejta për dëmshpërblim, për shkaktimin e dëmit jopasuror, vjen vetëm nëse individit ka pësuar më parë një dëm në fizikun e tij dhe në rastet kur kjo e drejtë njihet shprehimisht nga dispozita të Kodit Civil e që lidhen me dëmin e shkaktuar për shkak të shpifjes apo fyerjes, apo edhe në raste të veçanta si pasojë e diskriminimit, nuk njihen raste të tjera të një praktike gjyqësore në këtë aspekt. Pikërisht edhe për këtë arsye ky vendim i gjykatës është një sukses jo vetëm për të drejtën e informimit por edhe për dëmin moral të pavlerësuar ende ashtu siç duhet nga jurisprudenca vendase.

6.2. Konsolidohet praktika gjyqësore në dhënien e vendimeve me ekzekutim të përkohshëm, duke shtuar edhe 6 raste të tjera

Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, informacioni është “një mall që kalbet” dhe aksesit në të duhet bërë në një kohë sa më të shkurtër, pasi vonimi i publikimit të një ngjarjeje përtej një kohe të arsyeshme, me qëllim që gazetari të kontrollojë saktësinë e ngjarjes në rrethanat e veçanta të secilit rast, mund t’ia ulë vlerën ngjarjes. Kështu, në rast të një lajmi të rëndësishëm, kur gazetarët janë nën presionin e kohës dhe nuk mund të shtyjnë botimin e lajmit, Gjykata merr parasysh urgjencën e çështjes kur vlerëson nëse gazetarët kanë vepruar me përgjegjshmëri.

Çështjet gjyqësore me objekt aksesin në informacion marrin shumë kohë në përgjithësi, dhe për më shumë momentalisht, për shkak të efekteve negative të reformës në drejtësi që ka ngadalësuar sistemin gjyqësor për shkak të numrit të ulët të gjyqtarëve të mbetur në sistem. Në çdo rast autoritetet, pasi humbasin çështjen në gjykatën e shkallës së parë, ankohen në Gjykatën e Apelit. Kohëzgjatja e pritjes shkon mbi 4 vjet dhe informacioni e humbet aktualitetin. Megjithatë, një dispozitë e veçantë në Kodin e Procedurës Civile (neni 317, paragrafi i fundit) parashikon se gjykata e shkallës së parë mund të urdhërojë ekzekutimin e vendimit menjëherë sapo gjykimi përfundon në shkallë të parë, pavarësisht ankimimit. Ky mekanizëm përdoret për përfitim të të drejtës për ushqim, si dhe në disa raste të dëmshpërblimeve të punëmarrësve. Nisur që nga viti 2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, përdori këtë mekanizëm për aksesin në informacion, në një rast të nisur nga gazetari Artan Rama, çështje që u përfaqësua nga Res Publika. Në 10 raste të tjera, gjatë vitit 2020 u kërkua aplikimi i të njëjtit mekanizëm, rast i cili trajtohet në vijim. Kjo praktikë e bën të mundur aksesin në informacion relativisht herët, pavarësisht se shqyrtimi i vendimit pas ankimimit në gjykatën e apelit kërkon një kohë tepër të gjatë.

Gjykimet e sipërpërmendur janë përfaqësuar nga Res Publica dhe janë iniciuar nga M.D., gazetar pranë qendrës së gazetarisë investigative Faktoje.al, i cili si fillim iu drejtua 11 institucioneve shtetërore të qeverisjes qendrore për të marrë informacion mbi shpenzimet e titullarit të institucionit në udhëtimet jashtë vendit, gjatë periudhës Janar 2018 - Korrik 2019. Ky investigim është kryer në vazhden e një lajmi që bëri jehonë, për shpenzimet e Ministres së Drejtësisë, të gjetura nga i njëjti gazetar dhe të publikuara nga e njëjta media online. Institucionet fillimisht refuzuan dhënien e informacionit, në rastin më të keq tërësisht, e në disa raste pjesërisht, duke mos bashkangjitur faturat që vërtetojnë shpenzimet e udhëtimeve

të titullarëve. Si pjesë e procesit administrativ, gazetari M.D. iu drejtua Komisionerit për të Drejtën e Informimit për të detyruar institucionet të japin informacionin e kërkuar. Për shkak të mosreagimit të Komisionerit, gazetari iu drejtua gjykatës me kërkesë padi. Nëpërmjet procesit gjyqësor ai kërkoj dhënien e faturave dhe informacionit lidhur me shpenzimet financiare të titullarëve të 10 institucioneve shtetërore dhe dhënien e vendimit me ekzekutim të menjëhershëm. Për 6 prej tyre, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi të pranojë kërkesën për ekzekutim të menjëhershëm të vendimit, pra që faturat të vihen në dispozicion, me përfundimin e gjykimit në shkallën e parë, edhe pse palët humbëse (institucionet shtetërore) i kanë kundërshtuar këto vendime në apel. Kjo praktikë e krijuar më herët në gjykatën administrative kur përfaqësimi i gazetarëve është bërë nga Res Publica, me këto raste shkon gjithnjë e më tepër drejt konsolidimit dhe për këtë arsye konsiderohet një sukses në fushën e të drejtës për informim.

6.3. Sekretet shtetëror, një justifikim i paprecendet për të mos bërë publik një Vendim të Këshillit të Ministrave

L.Ç., një tjetër gazetarë investigative e mirënjohur në Shqipëri për investigime të forta në luftën kundër korrupsionit me një eksperiencë 15 vjeçare, së fundi punon për Projektin Reportimi i Korrupsionit dhe Krimin të organizuar. (Organized Crime and Corruption Reporting Project - OCCRP).

Me qëllim të një investigimi, ajo kërkoj nga dy organe publike, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Këshilli i Ministrave, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 115/2018, për lidhjen e kontratës së lobimit ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë “APCO WORLDWIDE”. Të dyja këto institucione refuzuan dhënien e informacionit me arsyetimin se ky vendim është sekret shtetëror. E njëjta përgjigje u dha edhe nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, pas ankimit administrativ, pa u bërë më parë një hetim administrativ nga ana e këtij organi.

Në parim një Vendim i Këshillit të Ministrave duhet të publikohet në Fletoren Zyrtare, por edhe sikur të abstrahonim jashtë këtij detyrimi, ky akt nuk duket se ka përmbushur kriteret për të qenë i tillë, sepse nuk bëhet e ditur nëse ka një vendim që ta ketë shpallur VKM-në në fjalë sekret shtetëror. Për këtë arsye gazetarja, me mbështetje e qendrës Res Publica, iu drejtua gjykatës për të siguruar këtë informacion. Pavarësisht praktikës së Gjykatës Administrative, gjykata në këtë rast nuk pranoi padinë për shqyrtim me arsyetimin se ishte dorëzuar jashtë afatit.

Të njëjtën kërkesë për informacion i drejtoi Res Publica, si administratore e platformës “Publeaks”, dy institucioneve, të cilët refuzuan përgjigjen në të njëjtën mënyrë. Kjo padi është ngritur menjëherë për të shmangur çdo keqinterpretim të afateve dhe është ende në gjykim dhe në kohën e këtij raporti, për pasojë nuk ka një rezultat ende.

Deklarimi i dokumenteve sekret shtetëror nga ana e institucioneve pa një referencë ligjore konkrete, pa një vendimarrje që shoqëron procedurën dhe pa u hetuar administrativisht nga ana e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, është një problem me të cilin haset aksesin në informacion.

Kjo është hera e parë kur një VKM deklarohet sekret shtetëror, ndërkohë që ligji përcakton se akti merr fuqi ligjore vetëm pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

6.4. Akses i gazetarëve në proceset gjyqësore dhe roli i gjyqtarit të medias

Në nenin 46 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e sistemit gjyqësor”, u prezantua për herë të parë “gjyqtari për median”, i cili ka për kompetencë të ushtrojë ose të mbikqyrë shërbimet e marrëdhënieve me publikun, duke u kujdesur për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim që:

- a) t’i sigurohet medias dhe publikut informacion faktik rreth vendimeve gjyqësore dhe për korrigjimin e gabimeve të mundshme mbi faktet për çështje të caktuara;
- b) t’i komunikohet medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes publik;
- c) të mbahen kontakte me median për seancat gjyqësore të çështjeve që kanë interes të veçantë publik;
- ç) të sigurohet informacion, në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit”, në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore;

Gjithashtu në po të njëjtën dispozitë parashikohet publikimi i të gjitha vendimet gjyqësore në përputhje me ligjin. E gjithë kjo konsiderohet si shërbim i marrëdhënieve me publikun që ndërvepron dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor mbi ecurinë e marrëdhënieve me publikun pranë gjykatave dhe kërkon mendimin e tij kur është e nevojshme.

Në zbatim të kësaj dispozite, KLGJ caktoi 8 gjyqtarë për median, konkretisht:

Juridiksioni	Emri i gjyqtarit	Adresa elektronike e kontaktit
Juridiksioni i Apelit Shkodër	Vojsava Osmanaj	vojsava.osmanaj@gjykata.gov.al
Juridiksioni i Apelit Tiranë	Edlira Petri	edlira.petri@gjykata.gov.al
Juridiksioni i Apelit Durrës	Desart Avdulaj	desart.avdulaj@gjykata.gov.al
Juridiksioni i Apelit Vlorë	Klodiana Gjyzari	klodiana.gjyzari@gjykata.gov.al
Juridiksioni i Apelit Korçë	Etleva Temo	etleva.temo@gjykata.gov.al
Juridiksioni i Apelit Gjirokastrë	Enton Dhimitri	enton.dhimitri@gjykata.gov.al
Juridiksioni i Apelit KKO	Saida Dollani	saida.dollani@gjykata.gov.al
Juridiksioni i Apelit Administrativ	Lindita Sinanaj	lindita.sinanaj@gjykata.gov.al

Për shkak se emërimi i gjyqtarëve për median nga KLGJ u bë i mundur vetëm në vitin 2019, ka jo shumë praktikë në këtë funksion, por praktika e deritanishme raportohet të jetë pozitive. Në dy raste Gazetari A. R. ka siguruar informacionin e kërkuar (material në CD audio të seancës gjyqësore) nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pas refuzimit nga kjo e fundit, pasi ka ankimuar refuzimin të gjyqtari për median. Kjo praktikë është zhvilluar në një kohë shumë të shkurtër (brenda 20 ditësh nga ankimimi gazetari ka siguruar informacionin).

Në kontrast, Komisioneri për të Drejtën e Informimit, i cili e ka detyrë të posaçme funksionale vendimarrjen për ankimime, nuk vepron shpejt në kohë, edhe në rastin më të mirë kur shqyrton një ankim të kësaj natyre duke e pranuar ankimin. Në fakt politikat e kësaj zyre deri tani kanë favorizuar ndrydhjen e informacionit, me argumente të ndryshme, ku mbizotëron mbrojtja e të dhënave personale kundrejt transparencës. Në këtë frymë aspak pozitive, është edhe iniciativa për hartimin e draftit të Urdhërit “Për mënyrën e publikimit të vendimeve gjyqësore në portalin elektronik të gjykatave, si dhe në faqet zyrtare të internetit të gjykatave”, i cili trajtohet te kapitulli 4 më lart.

6.5. Zyra e Presidentit të Republikës, rezistencë aktive ndaj ekzekutimit të vendimit gjyqësor

Presidenca është një nga institucionet shtetërore që u padit nga gazetari M.D., pranw Qendrës “Faktoje”, siç u trajtua më sipër. Këtij institucioni iu kërkuan detaje mbi shpenzimet e udhëtimeve të titullarit, si edhe dokumentat justifikuese (fatura, mandate, etj). Gjykimi përfundoi me një vendim që detyron Presidentin e Republikës të japë të gjithë informacionin e kërkuar dhe ky vendim duhej të ekzekutohej menjëherë, pa pritur që vendimi të merrte formë të prerë (ekzekutimi i përkohshëm). Vlen të përsëritet se institucionet shtetërore pa përjashtim, pas përfudnimit të çështjeve me objekt kërkimin e informacionit, ankimojnë çdo vendim të gjykatës së shkallës së parë. Me vënien në lëvizje, përmbaruesi privat T. filloi procedurën e njoftimit të Presidentit të Republikës duke i kërkuar fillimisht ekzekutimin vullnetarisht të vendimit të gjykatës. Zyra e Presidentit refuzoi të ekzekutojë vendimin, por nuk u mjaftua me kaq. Mes shkresash zyrtare u bë intimiduese dhe kërcënuese për përmbaruesin. Vënia në lëvizje e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve solli si pasojë edhe një kërkesë nga kjo e fundit ndaj Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të diskutuar edhe vendimarrjen e gjyqtarit të çështjes dhe vendimeve të tjera të ngjashme. Në këtë mënyrë presioni shkon deri te gjyqtari i çështjes në formë zinxhir. Qendrimi i Presidencës është i paprecedent. Ndërsa është e zakonshme që institucionet të refuzojnë ekzekutimin vullnetar të vendimeve gjyqësore, nuk ndodh që një institucion i nivelit kaq të lartë, jo vetëm të rezistojë në vazhdim ndaj ekzekutimit të vendimit, por të bëjë njëkohësisht edhe veprime të hapura sulmuese ndaj përmbaruesit. Gjuha e përdorur në këto shkresa është joprofesionale, me tone prepotente, dhe mbi të gjitha sjellja e Presidencës është intimiduese për zbatuesit e ligjit. Ky reagim i është edhe më shqetësues, nëse e shohim efektin përtej rastit konkret, e specifikisht në faktin që ky reagim me gjasa do të ketë ndikim te ata pak gjyqtarë që kanë marrë vendime të respektueshme dhe kanë krijuar një praktikë të mirë gjyqësore, në çështje të së drejtës së informimit, pavarësisht se punojnë në kushte aspak normale dhe miqësore.

Vlen të theksohet se vendimet e gjykatës për urdhërimin e vënies në dispozicion të publikut (kërkuesve) të informacionit publik, në mënyrë të menjëhershme, bazohet jo vetëm në një arsye të shëndoshë, në jurisprudencën e GJEDNJ dhe në ligjin vendas, por parimisht edhe në Konventën e Tromsos (CEST No. 205), e cila në nenin 8 shprehet se procedurat gjyqësore për çështjet e të drejtës së informimit duhet të jenë *të përshejtura*.

8. TË DHËNA NGA PLATFORMA PUBLEAKS.AL

Platforma Publeaks.al nisi funksionimin në dhjetor të vitit 2016 për të lehtësuar përdorimin e ligjit për të drejtën e informimit për çdo qytetar që ka kuriozitetin dhe angazhimin publik për të marrë informacion rreth veprimtarisë shtetërore.

Publeaks.al përmban disa rubrika, si ajo e aplikimit të pyetjeve, ajo e gjurmimit të ecures së kërkesës, ajo e programeve të transparencës, etj. Një rubrikë e veçantë është edhe ajo që përmban guida dhe studime në këtë fushë. Gjatë këtyre tre viteve Publeaks.al është pasuruar me shumë informacione të publikuara, duke numëruar rreth 1800 informacione dhe dokumente zyrtare (në kohën e këtij studimi), të publikuara në format lehtësisht të aksesueshëm nga publiku.


Pavarësisht se ky nuk është objekti kryesor i studimit, Res Publica vazhdon ta shohë me interes vështrimin mbi të dhënat rreth karakteristikave të aplikantëve. Këto të dhëna mbledhen në momentin e aplikimit online. Jo të gjithë aplikantët dëshirojnë të ndajnë me stafin tonë të dhënat e tyre dhe në këto raste është respektuar e drejta për të mbetur anonim. Gjithsesi, edhe të dhënat e personave që kanë dëshiruar të ndajnë të dhënat e tyre, mbahen nga Res Publica dhe përdoren vetëm për qëllime studimore, si ai që paraqitet në vijim, pa evidentuar emra të veçantë aplikantësh. Res Publica ka përpunuar të dhëna nga aplikimet për indikatorët e mëposhtëm të cilët për këtë vit janë:

- përdorimi i Publeaks.al
- objekti i informacionit të kërkuar
- autoritetet publike të cilëve u drejtohet kërkesa
- arsimi i aplikuesve • mosha e aplikuesve
- gjinia e aplikuesve/eve

Indikatorët e mësipërm ndihmojnë për të kuptuar se cili është lloji më i zakonshëm i informacionit të kërkuar, cili grup është më i interesuar dhe kërkon të njihet me veprimtarinë e institucioneve, si paraqitet niveli i njohjes së ligjit në grupe të caktuar, etj.

8.1. Përdorimi i faqes Publeaks.al

Fig. 14 - Klikimeve në rubrikën e të drejtës së informimit në faqen Publeaks.al gjatë tre viteve të fundit



Nga grafiku i mësipërm vihet re se ka pasur një interes në rritje gjatë vitit 2020.


Interesi më i madh për të vizituar platformën është shfaqur në muajin Shtator 2020, ndërsa ka pasur më pak interes në muajt Prill - Qershor 2020, kohë e cila korrespondon me gjendjen e jashtëzakonshme (përfunduar më 23 Qershor 2020).

Luhajtjet presupozohen se kanë ardhur për shkak të krizës së krijuar nga paniku dhe masat ekstreme të qeverisë, të cilat zunë vëmendjen kryesore të publikut gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu muaji Maj 2020 ka qenë i shoqëruar me trazira publike, si protestat ndaj masave, ndaj mbylljes së Liqenit Artificial në Tiranë, prishjes së godinave të Teatrit Kombëtar, manifestimeve të grupeve femine, etj.

Ajo që bën përshtypje është rritja e interesit për të vizituar Publeaks.al gjatë vitit 2020 ndërkohë që nga Res Publica nuk është bërë publicitet i faqes. Një shkak mund të jetë edhe rritja e përdorimit të platformave online për të kryer komunikimet normale të kohës para pandemisë së shkatuar nga Covid-19. Një rritje masive e përdorimit të shërbimeve online është konstatuar kudo dhe ky trend mund të ketë afektuar edhe rritjen e përdorimit të Publeaks.al.

8.2. Aplikantët sipas grupmoshave

Nga të dhënat e mbledhura nga publeaks.al, konstatohet që subjektet që i janë drejtuar publeaks.al i përkasin të gjitha grup moshave.

Fig. 15 - Kategoritë e aplikantëve në Publeaks.al

Grup mosha më e interesuar për të marrë informacione gjatë vitit 2020, rezulton të jetë ajo mes 20-30 vjeç, duke vijuar me trendin rritës të nisur në vitin 2018. Kjo grupmoshë ka shfaqur interes sidomos pas fatkeqësive natyrore të tërmetit të 26 Nëntorit 2019 dhe ka vijuar gjatë pandemisë së shkaktuar nga Covid-19.

Grupmosha më pak e interesuar rezulton ajo 30-40 vjeç, e cila para dy vjetësh ka qenë kategoria më e interesuar. Kjo kategori është duke humbur interes në vazhdim për t'u angazhuar në çështje me interes publik.


Bie në sy fakti që ka një rritje të ndjeshme të interesit të personave mbi 50 vjeç. Kjo grupmoshë ka shfaqur veçanërisht interes në lidhje me informacione për menaxhimin e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19. Gjithashtu, kjo grupmoshë, njëloj si në dy vitet e mëparshme, ka shfaqur interes të veçantë për informacione mjedisore, fakt që është theksuar edhe në raportet e mëparshme.

Duhet theksuar se Res Publica ka marrë disa masa gjatë viteve të fundit që të promovojë Publeaks.al në grupmoshat e reja, të cilat ishin të painteresuara vite më parë. Publiciteti i bërë gjatë viteve 2018-2019 ka dhënë efektet e veta, sidomos kur ai është bërë gjatë trajnimeve të zhvilluara për tema të ndryshme.

8.3. Aplikantët sipas arsimimit

Në lidhje me arsimimin e aplikantëve, duke u bazuar në të dhënat e deklaruara prej tyre në rubrikat e aplikimit, konstatojmë që kemi aplikantë me nivele të ndryshme arsimit, përveç atyre me arsim 9 vjeçar.

Fig. 16 - Aplikantë në Publeaks.al sipas arsimit



Nga të dhënat e grafikut të mësipërm, konstatohet se grupi më i interesuar për të marrë informacione vazhdon të jetë ai me arsim të lartë. Kjo pjesë e popullsisë duket se ka ndërgjegjësim më të lartë për të drejtat dhe ka interes më të madh për çështje publike.

Nuk ka ndonjë diferencë të madhe në numrin e aplikantëve me arsim të mesëm, të cilët mbeten në të njëjtin nivel si në vitet e kaluara.


Ndërkohë që për të dytin vit rradhazi mungon interesi nga persona me arsim nëntëvjeçar, duke mos pasur asnjë aplikant.

Bie në sy fakti që këta personat pa arsim të lartë, ndonëse përbëjnë 85% të popullsisë, angazhohen në këtë fushë vetëm në masën 12%. Kjo demonstroi në vijim nevojën për të bërë fushata ndërgjegjësuere për këtë targetgrup me qëllim motivimin e tyre.

8.4. Aplikantët sipas gjinisë

Përsa i përket gjinisë së aplikuesve, edhe për vitin 2020 vihet re se nuk ka një interes të lehtë më të madh të gjinisë mashkullore në krahasim me gjininë femërore përsa i përket interesit për të përdorur të drejtën e informimit. Megjithatë kjo diferencë është e vogël. Raporti i aplikantëve meshkuj dhe femra për vitin 2018 paraqitet si më poshtë:

Fig. 17 - Aplikantë në Publeaks.al sipas gjinive



8.5. Aplikacioni Publeaks.al në platformën Android

Prej tre vitesh tashmë, Res Publica ka hedhur në qarkullim aplikacionin me emrin Publeaks, i cili lehtëson aksesin në këtë shërbim prej telefonit celular. Nëpërmjet këtij aplikacioni çdo person mund të aplikojë mes telefonit celular në çdo moment dhe nga çdo ambient, duke drejtuar pyetjen e tij në këtë platformë. Me rritjen e përdorimit gjithnjë e më shumë të telefonave në jetën e përditshme, edhe Publeaks ka qenë një aplikacion i përodur, duke e bërë portalin të jetë “i lëvizshëm”. Aplikacioni është ende në fazën e tij eksperimentale dhe ka regjistruar mbi 100 përdorues.

9. KONKLUZIONE

Si konkluzion të përmbledhur mund të themi se situata e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit vijon të jetë në nivele mediokre, larg qëllimit të ligjvënësimit dhe gjendja e fatkeqësisë natyrore e theksoi me shumë problematikën, duke shfaqur një mungesë të vullnetit për të bërë transparencë për informacionet në lidhje me fatkeqësinë natyrore, megjithëse kushtet diktonin një nevojë të shtuar për informimin e publikut dhe lehtësimin e punës së gazetarëve.

Klima e shkaktuar edhe nga miratimi i përkohshëm i “paketës Anti-Shpifje”, i vuri gazetarët e mediave online nën një tryzni që mund të pasohej nga vetëcensura. Qendrimi i qeverisë nuk shfaq shenja serioze reflektimi edhe pasi kjo paketë u kthye nga Presidenti i Republikës për rishyrtim në Kuvend dhe Komisioni i Venecias e kritikoi në tërësi draftin. Qeveria mbajti hapur qendrimin që do të sjellë një version të ri për miratim, duke mos hequr dorë nga përpjekja. Ky zhvillim është i lidhur ngushtë me të drejtën e informimit mbi dokumentat zyrtarë, sepse një gazetar i cili publikon një lajm dhe potencialisht përballet me një ankesë pranë organit administrativ, do të duhet të mbrohet brenda një afati shumë të shkurtër kohor. Mbrojtja do duhet të konsistojë te mbështetja e vërtetësisë së informacioneve në fakte dhe prova. Në rast se lajmi ose kritika e gazetarit ka në fokus veprimtarinë shtetërore (siç ndodh në shumicën dërrmuese të artikujve), gazetari duhet të ketë informacion zyrtar me shkresë ose email në mënyrë që të jetë i mbrojtur ndaj çdo ankese për lajm të pavërtetë. Kjo e bën të domosdoshme që gazetarët të kenë nevojë të aksesojnë shpejt dhe plotësisht dokumentet e kërkuara. Në të kundërt, ata nuk do të mund të sjellin lajmet në kohën e duhur para një publiku të interesuar mbi zhvillimet e fundit dhe me shumë gjasa do të bien në vetëcensurë. Aq më keq, kur në kushtet e fatkeqësisë natyrore gazetarëve u duhet të jenë linja e parë e përcjelljes së informacioneve te publiku, për interes të të gjithëve.

Shoqëria civile dhe qytetarët e angazhuar kanë hasur në vështirësi për të aksesuar informacionin rreth çështjeve të nxehta, si për shembull shembja e godinave të Teatrit Kombëtar.

Tashmë, gjithnjë e më shumë gazetarët dhe shoqëria civile po kërkojnë informacion më shumë se qytetarët e zakonshëm. Ndaj, interesi ynë kryesor nuk ndalet vetëm në statistikën

e rastit, por shtrihet te cilësia e zbatimit të ligjit për të siguruar aksesimin e informacionit sensitiv, plotësisht dhe në kohën e duhur.

Duke pasur këto shqetësime dhe pikëpyetje, gjetjet e këtij raporti japin një tablo problematike, e cila paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

9.1. Përsa i përket standardeve të Këshillit të Evropës për të drejtën e informimit në kohë krize

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se liria e informimit është cenuar në përgjithësi në kohën e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, pavarësisht se në terma statistikorë ndryshimet me periudhat e mëparshme janë zbutur për shkak të “përzierjes” së kërkesave sensitive me ato të ardhura nga qytetarët e thjeshtë që nuk kanë lidhje me menaxhimin e pandemisë. Më konkretisht:

- Ka munguar komunikimi efektiv dhe i hapur i qeverisë me mediat, duke monopolizuar informacionin vetëm përmes burimeve qeveritare apo burimeve personale të Kryeministrit Edi Rama (ERTV dhe llogaria e tij personale në Facebook). Monopolizimi i komunikimit ka ngritur shqetësime për llogaridhënien e qeverisë për menaxhimin e krizës dhe për lirinë e medias. Organizatat, si dhe dy media që janë degë ose franciza të mediave të huaja (Euronews dhe CNN) kanë ngritur shqetësimin që qeveria lejonte vetëm kamerat e ERTV të raportonte ngjarjet, duke bllokuar aksesin e mediave në raportimin e saktë e të vërtetë të situatës. Bllokimi i informacionit dhe zëvendësimi i tij me propagandë ka ndikuar për keq në qetësimin e publikut dhe menaxhimin e panikut, duke bërë që qytetarët të drejtojnë sytë kudo munden për t’u informuar, për sa kohë qeveria nuk ua ka mundësuar këtë gjë. Qeveria pati një qasje tepër të ashpër retorike mbi virusin, duke e konsideruar “situatën të ngjashme me luftën”, duke folur për “armikun e padukshëm”, nxori automjete të blinduara në rrugët e kryeqytetit dhe sanksionoi gjoba të rënda. Pati konfuzion midis popullatës në lidhje me masat e miratuara, si dhe mosbesimit dhe perceptimeve negative mbi aftësinë e Shqipërisë për të trajtuar siç duhet situatën. U krijua një Komitet Teknik i Ekspertëve për të marrë vendime për të përmbajtur epideminë, por puna e Komitetit u shoqërua me një informacion të kufizuar publik mbi kompetencat e tij dhe shkallën në të cilën rekomandimet e tij u shndërruan në vendime politike. Situata e pandemisë u shfrytëzua për propagandë nga Kryeministri Edi Rama, i cili mori drejtimin e komunikimit publik me një prani të vazhdueshme në rrjetet sociale dhe transmetuesin online personal ERTV. Kryeministri monopolizoi përmbajtjen dhe formulimin dhe mënyrën se si mediat e merrnin informacionin. Vendimet botoheshin fillimisht në llogarinë e Kryeministrit në Facebook dhe më vonë në Fletoren Zyrtare. Konferencat për shtyp në të vërtetë nuk ishin të hapura për gazetarët. Informacionet e përditësuara fillimisht montoheshin dhe transmetoheshin online. Edhe pse çdo ditë nga foltorja e Ministrisë së Shëndetësisë kanë dalë specialistë, profesionistë për të informuar mbi situatën e përhapjes së virusit, informacioni që jepnin në përgjigjet e pyetjeve të gazetarëve, të cilat u dërgoheshin orë më parë, ishte i kufizuar. Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se pati një centralizim të informacionit, duke mos i lejuar gazetarëve që të kryqëzonin informacionet me burime alternative.
- Gjatë gjendjes së shkaktuar nga Covid-19 nuk ka pasur një bashkëpunim mes medias dhe qeverisë, qoftë edhe sipas përcaktimeve të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”. Donatorët qeveritarë nuk rezulton të kenë mbështetur median apo proceset që lidhe me transparencën për situatën e krijuar dhe menaxhimin e saj.

- Sasia e madhe dhe e akteve rregullatore për pandeminë dhe ndryshimi i shpeshtë i tyre ka bërë që informacioni mbi aktet ligjore në kohën e krizës së shkatuar nga Covid-19 të ishte i pakuptueshëm, duke shkatuar konfuzion të madh jo vetëm në publik, por edhe mes profesionistëve të ligjit.
- Një problem i mprehtë gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkatuar nga Covid-19 ishte dhe cenimi i transparencës së gjykatave. Pezullimi i veprimtarisë gjyqësore gjatë periudhës 23 Mars 2020 deri më 29 Maj 2020 ka vonuar dhënien e vendimeve gjyqësore në dhjetëra raste të çështjeve lidhur me të drejtën e informimit të nisura nga gazetarët investigues. Për periudhën në vazhdim, nuk janë lejuar gazetarët dhe publiku për të marrë pjesë në seancat gjyqësore. Duke u kombinuar ky problem me atë të anonimizimit të proceseve gjyqësore, gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 është cenuar në mënyrë tepër të ndjeshme informimi për veprimtarinë gjyqësore.
- Pavarësisht të dhënave statistikore, treguesit cilësorë shfaqin probleme specifike për gazetarët investigues në lidhje me informacionet më sensitive.

Standardet e Këshillit të Evropës janë një udhëzues dhe matës i mirë i respektimit të të drejtës së informimit në një shoqëri demokratike. Pjesa më e madhe e standardeve në fjalë nuk janë respektuar nga qeveria gjatë pandemisë së shkatuar nga Covid-19. Përveç se ky është një problem i madh në aspektin e vlerave demokratike, komunikimi i monopolizuar, pengimi i gazetarëve të bëjnë punën e tyre, ka prodhuar një krizë besimi mes publikut dhe qeverisë. Kjo e fundit nuk ka pasur qasjen e duhur që të informojë pa bërë propagandë dhe të pranojë kritikën, duke vënë kështu në rrezik masat anti Covid-19 dhe duke thelluar hendekun e besimit të qytetarët, për aftësitë dhe qëllimet e qeverisë.

9.2. Për sa i përket veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit

- Numri i ankesave të paraqitura para Komisionerit në vitin 2020 është më i ulët se vitin e kaluar, por mjaft i lartë duke marrë në konsideratë faktin që për disa muaj u paralizua jeta publike për shkak të pandemisë. Komisioneri ka marrë vendim vetëm për 5% të ankesave gjatë vitit 2020, duke shënuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin e kaluar, kur ishte 2%, por ende vendimmarrja mbetet në nivele shumë të ulëta.
- Pjesa dërrmuese e ankesave (68%) vazhdon të trajtohet përmes praktikës që vitet e mëparshme quhej “zgjidhje me ndërmjetësim” dhe tashmë quhet “vënie në dispozicion i informacionit ankuesit”, por që, nisur nga një hetim pjesor që Res Publica zhvilloi në vitin 2019 duke sjellë shembuj, ekziston një dyshim se kjo është një panoramë pjesërisht fiktive. Shifrat për vitin 2020 janë të ngjashme me ato të vitit 2019 dhe gjatë këtij viti ende ka gazetarë që raportojnë se nuk kanë marrë informacionet e kërkuara pavarësisht se Komisioneri i deklaroi si raste të zgjidhura. E vetmja diferencë në këtë vit është që numri i rasteve që kemi dijeni gjatë vitit 2020 është më i ulët se sasia që nevojitet për të dalë në konkluzione, duke diktuar nevojën për një hulumtim më të zgjeruar.
- Sanksionet e aplikuara ndaj refuzimeve për dhënien e informacionet në këtë vit janë zero.
- Komisioneri, përgjithësisht ka respektuar afatet ligjore, megjithëse numri i vendimeve ende nuk i përgjigjet numrit të lartë të ankesave.
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile ka qenë i pjesshëm dhe selektiv, duke shmangur kritikën si qendra Res Publica, raportet e së cilës janë komentuar me përçmim nga Komisioneri, pa dhënë asnjë argument.

Pjesa dërrmuese, 68% e ankimeve, raportohen nga zyra e Komisionerit se janë zgjidhur përmes praktikës “vënie në dispozicion të informacionit ankuesit” që është e njëjta me praktikën e mëparshme të quajtur “zgjidhje me ndërmjetësim”.

Në një vështrim në thellësi, që Res Publica bëri vitin e kaluar, rezultuan raste që hidhnin dyshime të forta mbi vërtetësinë e këtyre shifrave. Shumë raste të zgjidhjes me ndërmjetësim nuk ishin në fakt “zgjidhje”, ashtu siç sugjeronte emërtimi, por dyshohej se këtu futeshin edhe rastet kur Komisioneri thjesht ka dërguar një shkresë te institucioni përkatës duke i kujtuar atyre detyrimet e ligjit, dhe/ose kishte nisur një hetim paraprak administrativ, por nuk kishte vepruar më tej, duke mos zgjidhur ankesën në përmbajtje, e thënë ndryshe pa marrë ankuesi përgjigje për ankimin e vet. Ky përfundim për vitin 2019 u bazua në numrin e ankimeve të tre gazetarëve investigative (A.R., L.Ç dhe M.D.) dhe një OJF-je (që kishin “vuajtur” apatinë e Komisionerit në mbi 50 raste), të cilët Res Publica i hasi vetëm sepse ata iu drejtuan kësaj organizate për përfaqësim dhe marrjen e informacionit në mes rrugës gjyqësore. Shifra e vitit 2020 është 68%, e ngjashme me 70% që ishte vitin e kaluar dhe duke u nisur nga fakti që vetëm 5% e rasteve janë trajtuar me vendim, kemi ende dyshime se kjo praktikë nuk reflekton tërësisht të vërtetën, pra që i është “vënë në dispozicion informacioni ankuesit”.

Pavarësisht se Gjykata Administrative gjatë vitit 2019 ka vendosur të konstatojë pavlefshmërinë absolute të shkresave të zyrtarëve të tjerë të zyrës së Komisionerit, kjo zyrë vijon të refuzojë informacionin përmes shkresave të pavlefshme të këtyre zyrtarëve, të cilët veprojnë në tejkalim të kompetencave ligjore. Në vitin 2020 rezultojnë 23 raste të kësaj tipologjie, pa reflektuar arsyetimin e gjykatës në rastet e mëparshme.

Komisioneri nuk ka marrë vendim për 95 % të ankesave, dhe nuk ka vendosur asnjë sanksion me gjobë.

Neglizhimi në marrjen e masave për përmirësimin e programeve të transparencës vijon të ndikojë në fluksin e kërkesave dhe ankesave, me pasojë rëndimin e panevojshëm të punës së vetë Komisionerit.

Komisioneri mund dhe duhet të ndryshojë qasje ndaj raporteve kritike, të cilët kanë qëllim të përmirësojnë sistemin dhe jo të normalizojnë zbatimin e pjesshëm të ligjit.

9.3. Për sa i përket reagimit ndaj kërkesave për informacion

- Kërkesat fillestare nuk marrin një përgjigje të plotë në 40% të rasteve.
- Kohëzgjatja mesatare e kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave fillestare vazhdon të jetë përtej afatit ligjor, në mënyrë të ngjashme me dy vitet e fundit, mesatarisht për 25 ditë kalendarike. Kjo shifër është pothuaj e njëjtë me atë të viti 2013, kur në fuqi ishte ligji i vjetër, i cili parashikonte një afat prej 40 ditësh për kthimin e përgjigjes.
- Pas ankimit administrativ kërkuar mesatarisht duhet të presë edhe 16 ditë të tjera kalendarike, në rastin më të mirë kur ai e merr përgjigjen e plotë në këtë fazë.
- Kohëzgjatja e vendimmarrjes së Komisionerit është në nivelin e vitit të kaluar në një mesatare prej 22.5 ditësh.

- Kërkesat që lidhen me informacione sensitive zakonisht janë refuzuar, shpesh pa shkak ose për shkaqe të përgjithshme dhe të pabazuara. Konkensionet, prokurimet, investimet me impakt në mjedis, përdorimi i burimeve natyrore, informacione që lidhen me kauzat qytetare etj., janë nga informacionet më të vështira për t'u aksesuar, në rastin më të mirë përmes gjykatës, ose në rastin më të keq aspak, për shkak të mos ankimit në gjykatë, apo vonesës së tejskajshme të procedurave gjyqësore që zgjasin mbi 4 vjet.

Reagimi ndaj kërkesave nuk ka ndryshim nga viti i kaluar, por duhet theksuar që viti 2020 u shoqërua me efektet e pandemisë së Covid-19. Vijnë situata ku në 40% të rasteve kërkesat nuk marrin përgjigje ose e marrin të paplotë atë. Përgjigjet nuk jepen në kohën e duhur. Informacionet më sensitive për publikun nuk aksesohen fare, ose aksesohen tepër vonë, deri në pikën që e humbin vlerën. Sjellja e autoriteteve publike është e njëjtë dhe e pandikuar nga ligji i ri që cakton afate më të shpejta. Komisioneri për të Drejtën e Informimit nuk merr vendimet për shumicën dërrmuese të ankesave. Autoritetet që refuzojnë të publikojnë informacionet kanë shumë mjete në dorë për të zvarritur dhënien e tij, deri sa çështjet dhe interesi për to të arkivohen. Informacionet e tjerë, ato që aksesohen më lehtë, por përsëri jashtë standardeve ligjore, janë zakonisht informacione që nuk hedhin dritë mbi veprimtarinë e rëndësishme shtetërore.

9.4. Për sa i përket problematikave të veçanta

- Vijnë të pengohet publikimi i seancave dhe vendimeve gjyqësore për shkak të anonimizimit të të dhënave personale, duke dëmtuar të drejtën e publikut për t'u informuar për veprimtarinë e gjykatave. Madje në vitin 2020 Komisioneri ka marrë nismën për të draftuar një Udhëzim të ri, i cili synon njëlojë anonimizimin e vendimeve gjyqësore, në kundërshtim me frymën e Kushtetutës, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke mos ia lënë këtë kompetencë vetë gjykatave për të anonimizuar rast pas rasti të dhënat, duke e vendosur anonimizimin si rregull standard dhe publikimin si përjashtim.
- Vijnë të mos publikohen në kohën e mënyrën e kërkuar nga legjislacioni mjedisor dokumenta që kanë të bëjnë me investime me impakt në mjedis dhe përdorimin e burimeve natyrore.
- Vijnë të shfaqet fenomeni i VKM-ve “sekrete”, mospublikimi i të cilave “aprovohet” nga zyra e Komisionerit pa bërë hetim mbi rastin.
- Praktika gjyqësore është në përmirësim, ku qendra Res Publica synon konsolidimin e praktikës së dhënies së vendimeve me ekzekutim të përkohshëm, si dhe është dhënë për herë të parë shpërblimi i dëmit në rast të refuzimit të informimit.
- Ka nisur me sukses ushtrimi i kompetencave të “gjyqtarëve të medias”, duke dhënë vendime pozitive dhe të shpejta për të krijuar akses të gazetarëve në veprimtarinë gjyqësore.
- Konventa e Tromsø (CETS 205/2009) e Këshillit të Evropës, si dokumenti më i ri ndërkombëtar në fushën e të drejtës së informimit, hyri në fuqi në muajin Dhjetor 2020. Shqipëria ka nisur procedurat e ratifikimit për këtë instrument. Komisioneri ka hartuar projektligjin përkatës dhe Këshilli i Ministrave me VKM nr. 1123, datë 30.12.2020, miratoi në parim Konventën për t'u çuar për veprime të mëtejshme për ratifikimin e saj me ligj. Konventa kërkon nga shtetet anëtare që të miratojnë procedura të përshpejtuara gjyqësore për aksesin në informacion, si dhe detyron shtetet të raportojnë në mënyrë të posaçme për këtë të drejtë, duke hapur një dritare advokimi edhe për shoqërinë civile.

Anonimizimi i të dhënave në gjykata pengon gazetarët dhe qytetarët që të mësojnë rreth veprimtarisë gjyqësore. Problem hasin edhe studiuesit që e kanë shumë të vështirë të sigurojnë të dhëna për studimet e tyre për përmirësimin e ligjeve dhe praktikës gjyqësore.

Proceset gjyqësore duhet të jenë publike dhe vendimet e gjykatës gjithashtu, siç parashikohet nga Kushtetuta dhe kodet. Nëse ka raste ku mund të cenohen të dhënat personale, është vetëm një autoritet i njohur nga ligji që mund të vendosë, dhe ky është gjyqtari/ja që është caktuar me short për çështjen. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Dhjetor 2020 në çështjen Dadashbeyli kundër Azerbajxhanit, ku palë e tretë ishte Res Publica, ka theksuar rëndësinë e gjykimit publik. Por, jo vetëm që nuk është marrë asnjë masë për të zgjidhur këtë problem, por, përkundrazi, Komisioneri ka përgatitur një draft udhëzim për të zbatuar një regjim anonimizimi të detajuar.

Informacionet dhe dokumentacionet për veprimtaritë me impakt në mjedis vijnë të mos trajtohen me rëndësi parësore. Mospublikimi i dokumenteve të rëndësishëm mjedisore, vijon të sjellë pasojën që publiku, veçanërisht ai i specializuar, siç janë organizatat në mbrojtje të mjedisit, të mos kuptojë dhe mos reagojë në kohën e duhur ndaj veprimtarive që potencialisht mund të dëmtojnë mjedisin përgjithmonë. Edhe këtë vit Komisioneri nuk ka marrë masa që situata të ndryshojë.

Dukuria shqetësuese e miratimit të VKM sekrete, e konstatuar në vitin 2019, vijon të mos hetohet nga Komisioneri. Aktualisht kjo çështje është në gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në terrenin problematik të përkshkruar më lart, Res Publica ka synuar të pasurojë praktikën gjyqësore si mjeti i fundit për të korrigjuar paligjshmëritë dhe për të siguruar informacionin. Gjykata Administrative tashmë ka marrë shume vendime për vënien në ekzekutim të menjëhershëm, duke mundur marrjen e informacionit shpejt përmes përmbauesve privatë, menjëherë pas përfundimit të gjykimit në shkallë të parë. I vetmi rast kur kjo procedurë ka hasur në vështirësi është me Presidentin e Republikës, i cili refuzon të ekzekutojë vendimin e gjykatës dhe ka vënë në lëvizje Dhomën Kombëtare të Përmbauesve për të komplikuar më tej zbatimin e vendimit, duke ushtruar për rrjedhojë presion mbi përmbauesin privat që ka kërkuar ekzekutimin e vendimit.

Praktika gjyqësore u pasurua edhe më tej gjatë vitit 2020, duke shënuar rastin e parë të shpërblimit të dëmit për shkak të vonësës ose refuzimit të lëvrimit të informacionit ndaj gazetarëve. Ky rast mund të shërbejë si një trysni pozitive për të detyruar institucionet të trajtojnë kërkesat e gazetarëve me seriozitet nga frika për pagesën e një dëmshpërblimi eventual.

Një hap pozitiv është krijimi i një praktike të mirë nga vendimet e “gjyqtarëve të medias”, duke dhënë vërtet në kohë të shpejtë aksesin në veprimtarinë gjyqësore, pavarësisht se gjyqtarët në këtë periudhë janë veçanërisht të ngarkuar me proceset gjyqësore të punës së tyre rutinë.

Një hap tjetër pozitiv është edhe nisja e procedurave për të ratifikuar Konventën e Tromsø, e cila krijon mundësi përmirësimi të mëtejshme të legjislationit.

9.5. Për sa i përket programeve të transparencës (publikimi i informacioneve pa kërkesë)

- Vijon situata ku **asnjë** institucion nga 100 të monitoruarit (më të rëndësishmit në vend), nuk e ka përmbushur plotësisht programin e transparencës.
- Vijon situata ku më pak se 1/5 e autoriteteve kanë përmbushur gjysmën ose më shumë të kërkesave të ligjit për këto programe. Pjesa tjetër, ose pjesa dërrmuese ka përmbushur pak, ose aspak kërkesat e ligjit.
- Vijon situata ku 1/4 e autoriteteve nuk kanë fare një program transparence.
- Megjithëse Komisioneri ka miratuar një model të ri të “programit të transparencës”, vijon situata ku modeli është i unifikuar dhe i papersonalizuuar sipas llojit të institucioneve, të cilët kanë një larmi të madhe.
- Vijon të degradojë situata e “regjistrimit të kërkesave e përgjigjeve”, ku në dy vitet e fundit (2019-2020) ka një rënie konstante të treguesve, të cilët kanë qenë në nivele alarmante edhe më herët, në vitin 2018.
- Ka nisur aplikimi i sanksioneve me gjobë për mospërmbushjen e detyrimeve në lidhje me programet e transparencës, por deri tani këto gjoba janë aplikuar vetëm ndaj tre bashkive të vogla, ndërkohë që institucionet e rëndësishëm janë ende larg standardit të kërkuar nga ligji
- Ende vijon situata ku 1/4 e autoriteteve më të rëndësishme nuk ka caktuar një koordinator për të drejtën e informimit (ose nuk e bën publik këtë fakt duke mos publikuar të dhënat e tij).
- E vetmja shenjë pozitive lidhet me “regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve”, që është miratimi i modelit të ri nga Komisioneri.
- Vijon të mbështetet nga Komisioneri përdorimi i “tarifave” dhe jo “kostos së riprodhimit” për dhënien e dokumenteve, siç e kërkon ligji. Në këtë mënyrë, institucionet janë legjitimuar të aplikojnë tarifa të tilla sikur po e shesin me fitim shërbimin dhe jo ta japin atë falas.

“Programet e transparencës” kanë dështuar si risi e ligjit të vitit 2014. Pjesa më e rëndësishme e autoriteteve publike vazhdojnë të mos marrin mundimin as të publikojnë një regjister sa për sy e faqe dhe kjo tregon për mungesë të theksuar të seriozitetit në trajtimin e këtij aspekti të rëndësishëm.

Në shumë raste informacionet janë të vjetëruara dhe pa vlerë aktuale. Situata qartësisht është frenuar prej disa vjetësh në një nivel shumë të ulët, në kuotën 25% të lartësisë (madje me pak rënie) që kërkon ligji dhe nuk ka përpjekje serioze nga Komisioneri për të marrë masa. Ky organ ka nisur këtë vit aplikimin e gjobave, por deri tani vetëm ndaj institucioneve me “peshë të lehtë”, dhe nuk na rezulton që të ketë marrë masa për institucionet kryesore në vend.

Gazetarët nuk e përdorin programin e transparencës, pasi informacionet për kontratat, prokurimet, etj. nuk publikohen nga pjesa dërrmuese e institucioneve.

Edhe situata në lidhje me regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve rezulton e dështuar, madje me një trend përkeqësues. Qëllimi i ligjit rezulton i papërmbushur në masë tepër të madhe.

9.6. Për sa i përket interesit të qytetarëve për të përdorur të drejtën e informimit

- Gjatë 2020 është rritur edhe më tej interesi i gazetarëve dhe aktivistëve.
- Vijon të tregohet interes më i lartë nga persona me arsim të lartë.
- Ka një rikthim të vazhdueshëm të interesit nga grumoshat 20-30 vjeç, e cila para dy vitesh ishte e painteresuar, ndërsa vitin e kaluar pati rritje dhe gjatë vitit 2020 ka qenë grupmosha më e interesuar.
- Ka një interes të meshkujve pak më të lartë në raport me femrat, pavarësisht se kampioni i marrë për bazë është i vogël për të përfaqësuar trendin e përgjithshëm të popullsisë.

Edukimi dhe interesi për çështjet publike duket se janë faktorët që ndikojnë te personat që e përdorin më shumë ligjin për të drejtën e informimit. Rritja në vazhdim e interesit të të rinjve është tregues i mirë.

10. REKOMANDIME

Nisur nga konkluzionet e mësipërme dhe në vijim të monitorimeve të vazhdueshme që nga vitet e kaluara, rekomandojmë sa vijon:

Rekomandimi nr. 1

Gazetarët të kenë akses të shpejtë në informacionet që lidhen me menaxhimin e krizës

Autoritetet publike që menaxhojnë krizën duhet të garantojnë aksesin në informacion të gazetarëve, kudo ku gazetari e shih të arsyeshme, për hir të rritjes së besimit të publikut te autoritetet, të cilët shfaqin sjellje transparente dhe pranojnë kritikën. Në rast se lind nevoja për të garantuar sigurinë e gazetarëve, të zhvillohen protokolle sigurie për të mundësuar që gazetari të mos pengohet në kryerjen e detyrës së tij.

Rekomandimi nr. 2

Rekomandohet aplikimi i konferencave të hapura për shtyp, me pyetje në kohë reale

Autoritetet që menaxhojnë krizën duhet të sigurojnë informacion të rregullt për të gjithë gazetarët, duke i lënë mundësinë atyre të bëjnë pyetje në kohë reale në konferencat për shtyp dhe me çdo lloj mjeti tjetër të përshtatshëm.

Rekomandimi nr. 3

Të rishikohen sanksionet joproporcionale ndaj gazetarëve dhe aktivistëve

Qeveria duhet të marrë masa të rishikojë sanksionet joproporcionale ndaj gazetarëve, ndërkohë që duhen marrë masa për të vënë përpara përgjegjësisë cilindo zyrtar që përpiket të manipulojnë opinionin, duke shfrytëzuar dobësitë e publikut në raste krizash.

Rekomandimi nr. 4

Kuvendi i Shqipërisë përpara hartimit dhe miratimit të Rezolutës për Vlerësimin e Punës së Komisionerit të informohet si janë zbatuar rekomandimet e Rezolutës parardhëse; të marrë parasysh, përveç raporteve të vetë Komisionerit edhe raporte/monitorime të aktorëve të tjerë, si dhe të ftojë në seancë edhe organizata të medias dhe të shoqërisë civile.

Në kushtet kur konstatojmë se nga njëra anë veprimtaria e zyrës së Komisionerit rezulton të jetë e kritikueshme dhe jo në përmirësim, se kjo zyrë nuk merr masa të mjaftueshme për të zbatuar rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë në Rezolutat e përvitshme dhe nga ana tjetër këto rezoluta, përkundrazi, japin vlerësime pozitive për punën e Komisionerit në një mënyrë formale dhe të pambështetur në hulumtime e vlerësime objektive, pa prezantuar problematikat, rekomandojmë që Kuvendi dhe komisionet e tij të marrin parasysh, përveç raporteve të Komisionerit, edhe raporte të bëra nga organizata jo fitimrurëse, apo çfarëdo subjekti tjetër, si dhe rekomandojmë që ato të ftohen të marrin pjesë bashkë me organizatat mediatike në seancat dëgjimore të prezantimit dhe vlerësimit të punës së Komisionerit për të Drejtën e informimit. Madje këto organizata duhet të ftohen të japin vlerësime me shkrim lidhur me aktivitetin e Komisionerit.

Rekomandimi nr. 5

Komisioneri për të Drejtën e Informimit të fillojë një fushatë të mirëfilltë me masa administrative për institucionet që nuk kanë plotësuar programet e transparencës dhe regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, në respekt edhe të rekomandimeve të Rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë

Në një praktikë administrative të mirë sanksionet duhet të shihen si një e keqe e domosdoshme dhe të përdorshëm vetëm në rastet kur mjetet e tjerë kanë dështuar. Në kushtet kur programet e transparencës nuk janë plotësuar në masë të gjerë, kur regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve mungojnë ose nuk janë të plotë dhe të aksesueshme, pas 6 vitesh në të njëjtën situatë, madje duke u paraqitur edhe një trend përkeqësues, Komisioneri për të Drejtën e Informimit duhet të marrë masa në formë fushate. Në mënyrë të veçantë, Komisioneri mund të nxjerrë udhëzime të posaçme, sidomos për mënyrën e plotësimit të regjistrave. Mënyra e veprimit me tre bashki të vogla gjatë vitit 2020 mund të shrihet edhe në shumë institucione të tjerë të rëndësishëm.

Rekomandimi nr. 6

Komisioneri për të Drejtën e Informimit duhet të marrë vendim për çdo ankese, duke shmangur “zgjidhjet me ndërmjetësim” dhe/ose refuzimet mes shkresave të nëpunësve të tij pa delegim kompetence

Në disa vendime gjykatë ku janë vënë në diskutim shkresat e nëpunësve të zyrës së Komisionerit, është theksuar, përsëritur dhe ndonjëherë shpallur të pavlefshme juridikisht shkresat me të cilat nëpunësit e zyrës së Komisionerit u përgjigjen ankësive. Në këto kushte Komisioneri për të Drejtën e Informimit duhet të bëjë pjesë të praktikës së vet përgjigjen e ankimeve me vendim, si e vetmja formë që i njeht ligji për shprehjen e vullnetit. Çdo formë tjetër e ekspozon atë ndaj paligjshmërisë përveçse prodhon dhe efekte negative në garantimin e të drejtës për informim, si dhe shtrembërojnë realitetin duke pasqyruar shifra të dyshimta.

Rekomandimi nr. 7

Të zbatohen më shumë sanksione në rrethanat e justifikuara, sidomos në rastet e përsëritësve dhe në raste të tjera flagrante

Në kushtet kur shohim që ligji për të drejtën e informimit nuk respektohet në mënyrë masive dhe pothuaj rregullisht, duhen gjetur strategji të reja përveç pritjes për të besuar se dikur do të ndërgjegjësohet administrata. Një shembull i mirë se si bëhet që ligji të respektohet kur ai shkelet rregullisht, për shkak të mungesës së kulturës, vullnetit etj. është ligji kundër duhanit. Ai ligj u zbatua vetëm pas një fushate të mirëfilltë sanksionesh. Rast suksesi nga i cili duhen nxjerrë leksione, nëse mungon vullneti për të respektuar ligjin në mënyrë të përsëritur. Në këtë kuptim rekomandojmë që Komisioneri të nisë me aplikimin e sanksioneve në formë fushate, duke e nisur me paralajmërime e duke shkuar te gjobat, për ato rastet që janë flagrante kur refuzimi i informacionit bëhet për shkaqe neglizhence, mungese dëshire për të bërë transparencë, kundër një vendimeve të Komisionerit, etj.

Rekomandimi nr. 8

Nevojitet të rishikohet rekomandimi i dhënë për anonimizimin e të dhënave në gjykata dhe gjithashtu edhe drafti i Udhëzimit të ri për të njëjtim qëllim

Përsërisim në këtë raport të njëjtin udhëzim të mëparshëm, por duke shtuar edhe përpjekjen për hartimin e një udhëzimi të ri për anonimizimin e vendimeve gjyqësore. Udhëzimi aktual për anonimizimin e të dhënave në gjykata, si dhe drafti i ri, janë në të njëjtën frymë, atë të krijimit të kufizimit si rregull, dhe publikimit si përjashtim. Nevojitet që qasja të jetë në frymën e kundërt, atë të publikimit si rregull, dhe të anonimizimit si përjashtim, si dhe për t'ia lënë këtë kompetencë gjykatave, siç përcakton Kushtetuta, kodet dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rekomandimi nr. 9

Të përshtatet modeli i programit të transparencës për natyra të ndryshme të autoriteteve publike me fokus të veçantë publikimin e informacioneve për veprimtari me impakt në mjedis

Megjithëse është miratuar një model i ri i programit të transparencës, vihet re që edhe ky model nuk është i përshtatshëm për të gjithë autoritetet publike, duke paralajmëruar vështirësi në zbatimin e tyre, por edhe në përdorimin nga qytetarët. Meqenëse problematika e informacioneve për veprimtaritë me impakt në mjedis paraqet një rëndësi të veçantë, rekomandojmë që të vazhdojnë përpjekjet e Komisionerit për implementimin e një modeli që përfshin këto informacione në mënyrë eksplicite.

Rekomandim nr. 10

Të parashikohet në ligj mundësia për të ekzekutuar forcërisht vendimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit

Në mënyrë të përsëritur, rekomandojmë ndryshime në ligj, duke përfshirë një parashikim të veçantë që të mundësojë që vendimet e Komisionerit të jenë tituj ekzekutivë dhe mos ekzekutimi i tyre të përbëjë shkelje administrative.

Rekomandimi nr. 11

Për paditë me objekt kërkim informacioni, vendimi i gjykatës duhet të marrë formë të prerë që në shkallë të parë

Në mënyrë të përsëritur, rekomandojmë që në ligjin nr.49/2012, një nga llojet e padive për të cilat vendimi i gjykatës merr formë të prerë që në shkallën e parë të gjykimit të jenë edhe ato me objekt kërkimin e informacionit. Siç e kemi thënë edhe në studimet e mëparshme, përpara dërgimit të çështjes në gjykatë Komisioneri garanton një procedurë *quasi gjyqësore* dhe mbyllja e mundësisë së ankimit në një gjykatë më të lartë pas asaj të shkallës së parë nuk është shkelje e procesit të rregullt ligjor sipas standardeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo ndërhyrje ligjore do të përmbushte edhe një prej standardeve kryesore të Konventës së Tromsos, e cila aktualisht është në procedurë ratifikimi nga Republika e Shqipërisë.

Rekomandimi nr. 12

Rekomandohet të rishikohet kohëzgjatja e mandatit dhe mënyra e emërimit të Komisionerit

Ligji i jep Komisionerit një mandat 5 vjeçar dhe ai emërohet nga Kuvendi. Në kushtet kur Kuvendi dominohet nga e njëjta forcë politike që më pas dominon edhe autoritetet publike që do të mbikqyren nga Komisioneri, është e rëndësishme që ky i fundit të ketë fuqinë e duhur për të përballuar presionin e natyrshëm politik. Kështu, përveç zgjatjes së mandatit, nevojitet të rishikohet edhe skema e emërimit të Komisionerit, duke përfshirë në këtë skemë elementë kufizues të pushtetit politik dhe futjen e elementëve të pavarur, si për shembull propozimi të vijë nga universitetet, organizatat e mediave, apo shoqëria civile dhe shkarkimi të bëhet vetëm me propozim të tyre, përveç rasteve kur ka një shkelje të rëndë të ligjit apo arsye të tjera të përligjura dhe të pashmangshme, si dorëheqja, etj.

Rekomandimi nr. 13

Rekomandohet të rishikohet kostoja e riprodhimit të dokumentave zyrtarë

Ligji përcakton parimin se informacioni jepet falas. Në raste të veçanta, ligji i lejon autoritetet publike që të kërkojnë rimbursim të koston së riprodhimit të informacionit. Kostoja është vetëm ajo që ka të bëjë me kostot materiale dhe jo me shërbimin e kryer nga punonjësit e autoriteteve publike. Aktualisht Komisioneri ka lejuar aplikimin e “tarifave”, të cilat nuk përbëhen vetëm nga kostoja dhe për më tepër, në disa raste tarifatat janë më të larta se kostoja e fotokopjimit në tregun e lirë, e cila është çmim shitjeje. Nevojitet të rishikohet ky aspekt, në mënyrë që të shmangen pengesat abuzive në aksesin në informacion. Gjithashtu, Komisioneri duhet të kujdeset që institucionet të ofrojnë sa më shumë që të jetë e mundur, sipas kërkesës së vetë subjekteve kërkuar, dokumentat e skanuar dhe dërguar në rrugë elektronike, të cilat duhet të ofrohen pa pagesë, edhe nëse janë voluminoze.

Rekomandimi nr. 14

Rekomandohet që gazetarët të përdorin “gjyqtarët e medias” për të aksesuar shpejt informacione të proceseve gjyqësore

“Gjyqtarët e medias” janë një koncept i ri, i përfshirë pas vitit 2017 dhe aktualisht janë verifikuar raste suksesi të cilët janë premtues për një praktikë të mirë. Vendimet merren në

një kohë të shpejtë dhe janë lehtësisht të kërkueshëm duke kontaktuar me gjyqtarët e medias, sipas tabelës së publikuar në faqen 34 të këtij raporti.

Rekomandimi nr. 15

Rekomandohet që Komisioneri të bashkëpunojë me organizatat e shoqërisë civile, duke përfshirë edhe ato organizata apo grupime kritike

Një mjet i mirë për përmirësimin e praktikës është bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe marrja në konsideratë e kritikave të tyre. Komisioneri duhet të nxjerrë më të mirën nga raportet kritike dhe jo thjesht të polemizojë me organizatat kritike apo t'i shmangë ato nga diskutimet mbi veprimtarinë e tij.

Qendra “Res Publica”
“E drejta e informimit 2020 -
Informimi në kohë krize dhe problemet e tjera të zakonshme”
Mbështetur nga:
National Endowment for Democracy
Tiranë, Mars 2021
60 faqe
Format: 21 x 29.7 cm
Tirazhi 200 kopje

“...E drejta për informim është një e drejtë Kushtetuese, nga ku nis mbrojtja e të gjitha të drejtave të tjera Kushtetuese. Pa informacion nuk ka transparencë dhe pa transparencë nuk ka llogaridhënie.

Zyra e Komisionerit ka rol kyç për të trajtuar ankesat kundër institucioneve shtetërore, të cilët nuk japin informacion publik dhe nuk bëjnë transparente punën e tyre. Ne, aktorët më aktivë në kërkim të transparencës, shprehim shqetësimin tonë për sjelljen e Kuvendit që e trajton rregullisht këtë çështje si të ishte rutinë dhe e dorës së fundit.

Shprehim keqardhje që Komisioni për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, edhe këtë vit nuk mori masa siç vepron për çështje me rëndësi, për të siguruar pjesëmarrje të shoqërisë civile dhe gazetarëve, që disponojnë fakte dhe analiza studimore lidhur me zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. Shoqëria civile dhe gazetarët janë një zë serioz oponent që ndihmon deputetët të reflektojnë mbi gjendjen reale dhe për të adresuar shqetësimin e vërtetë të subjekteve.

Shprehim zemërim, kur shohim se si deputetët e Kuvendit injorojnë debatin si me publikun e interesuar edhe mes tyre, të cilët e kanë kufizuar misionin e deputetit në funksionin e një Noteri Publik, që certifikon çdo akt që i paraqitet mbi tavolinë.

Me këtë Deklaratë i bëjmë thirrje Kuvendit dhe faktorit ndërkombëtar, të kthejnë kokën nga zëri alternativ i shoqërisë civile për të vlerësuar çështje të rëndësishme dhe të mos marrin për bazë vetëm burimet vetëvlerësuese të zyrave të shtetit si Komisioneri për të Drejtën e Informimit apo Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura në Kuvend...”

Pjesë nga deklarata për shtyp e datës 26 Maj 2020 e 12 organizatave më të angazhuara për transparencën e institucioneve dhe 3 gazetarëve investigues, në lidhje me vlerësimin nga Kuvendi të raportit vjetor për vitin 2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit.